

V E N D I M
Nr.251,datë 20.4.2001

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT “PËRCAKTIMI I HAPËSIRAVE TË PËRSHTATSHME
PËR NDËRTIMIN E DEPOZITAVE BREGDETARE TË NAFTËS, TË GAZIT DHE TË
NËNPRODUKTEVE TË TYRE”**

Në mbështetje të pikave 1 dhe 2 të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e studimit “Përcaktimi i hapësirave të përshtatshme për ndërtimin e depozitave bregdetare të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për hapësirat e paraqitura në studim, të fillojnë procedurat ligjore për shqyrtimin e tyre, në zbatim të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Transportit, Ministria e Punëve Publike dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në bashkëpunim me organet përkatëse të njësive të qeverisjes vendore të përgatisin, nëpërmjet institucioneve studimore dhe projektuese në vartësi të tyre, masterplanin e vendosjes së stacioneve të depozitave bregdetare dhe instalimeve portuale, së bashku me infrastrukturën përkatëse në hapësirat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi. Paraqitja e masterplanit për shqyrtim në KRRTRSH të bëhet brenda datës 30.4.2001.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 355, datë 27.5.2001

PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË KONCENSION TË HIDROCENTRALEVE VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 5 dhe 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” dhe të nenit 2 të ligjit nr.8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurave të privatizimit në formë koncensionit të 31 hidrocentraleve vendore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, me shoqërinë “VEVE & ESSEGEI”, sipas ofertës së pakërkuar.

2. Forma e kontratës koncensionare të jetë ROT (rehabilitim, operim, transferim)

3. Organi i autorizuar shtetëror për negocimin dhe për nënshkrimin e kësaj kontrate, të jetë Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Nr.	Emërtimi	Rrethi	Kapaciteti aktual (kW)
1	Shoshan	Tropojë	230
2	Orgjost	Kukës	400
3	Lenie	Gramsh	400
4	Lozhane	Korçë	145
5	Lek-Bibaj	Tropojë	400
6	Arras	Dibër	1200
7	Dukagjin	Shkodër	640
8	Lurë	Dibër	400
9	Lunik	Librazhd	200
10	Homezh	Bulqizë	150
11	Xhyrrë	Librazhd	250
12	Treskë 2	Korçë	130
13	Tuçep	Bulqizë	400
14	Funares	Librazhd	1040
15	Vithkuq	Korçë	720
16	Nikolic	Korçë	500
17	Bulqizë	Bulqizë	400
18	Velçan	Korçë	320
19	Zerqan	Bulqizë	250
20	Borsh	Sarandë	250
21	Leshnicë	Sarandë	250
22	Martanesh	Mat	240
23	Ujanik	Skrapar	220
24	Kërpic	Gramsh	200
25	Barmash	Kolonjë	200
26	Voskopojë	Korçë	200
27	Piqerras	Sarandë	200
28	Çorovodë	Skrapar	200
29	Muhur	Dibër	200
30	Rajan	Kolonjë	200
31	Marjan	Korçë	200

Për VEVE Engineering & Consulting sh.p.k.
Rudolf Papa

Për ESSEGEI sh.p.k.
Viktor Hykollari

Drejtor

Përfaqësues i autorizuar

V E N D I M

Nr.358, datë 27.5.2001

PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE PËR NDËRTIMIN DHE PËRDORIMIN E INSTALIMEVE BREGDETARE PËR TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8450, datë 24.5.1999 “Për përpunimin, transportimin, tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të nenit 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të nenit 3 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të nenit 6 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore” dhe të nenit 3 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Instalimet bregdetare të transportimit dhe të depozitimit të naftës, të gazit dhe të nën

produkteve të tyre përfshijnë rezervuarët e magazinimit (stokimit) të produkteve dhe pajisjet përkatëse të trajtimit të tyre si dhe infrastrukturën portuale detare (bovat, platformat, linjat, tubacionet, etj), së bashku me pajisjet që shërbejnë për transportimin e produkteve nga anijet për në depozitat ose anasjelltas (pontili).

2. Ndërtimi dhe përdorimi i instalimeve të reja bregdetare për transportimin, depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, bëhet me leje koncensionale të Këshillit të Ministrave, pasi shoqëria kërkuar për të ushtruar këtë veprimtari të ketë plotësuar paraprakisht dokumentacionin e përcaktuar në këtë vendim.

3. Infrastruktura portuale detare e ngarkim-shkarkimit dhe e transportimit të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, deri në lidhjen tokësore, me depozitat e magazinimit të këtyre produkteve, pavarësisht se cili është investitori për ndërtimin e saj, mbetet pronë e shtetit dhe përdorimi i saj nga subjektet e interesuara bëhet kundërt qirasë. Procedura për administrimin e infrastrukturës portuale detare, kryhet në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Kriteret dhe vlera e qirasë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Administrimi i zonës portuale dhe i veprimtarisë në instalimet bregdetare të transportimit dhe të depozitimit të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, në zbatim të legjislacionit fiskal, të legjislacionit portual, të legjislacionit për mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen e mjedisit kryhet nga organi përkatës, në varësi të ministrisë përgjegjëse për transportin detar.

5. Shoqëritë që kërkojnë të ndërtojnë instalime të reja bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, së bashku me infrastrukturën portuale të ngarkim-shkarkimit për këto produkte, do të përdorin sipërfaqe ndërtimi në zonat e përcaktuara sipas vendimit nr.251, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave.

6. Instituti i Naftës dhe Gazit, si institucion i specializuar ose specialistë të licencuar në fushën e teknologjisë së instalimeve të impianteve dhe të depozitave bregdetare, bëjnë vlerësimin kundërt një tarife të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, si dhe japin miratimin për projektin teknologjik për depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, përfshirë edhe infrastrukturën portuale të ngarkim-shkarkimit për këto produkte.

7. Shoqëria që kërkon të ndërtojë instalime bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, duhet të ketë kërkesën, të shoqëruar edhe me këto dokumente:

- Vendimin e gjykatës për regjistrimin e personit juridik;

- certifikatën e regjistrimit në zyrën e tatimeve dhe dokumentin e NIPT-it;

- studimin urbanistik për shesh ndërtimi dhe projekti ndërtimor, së bashku me vendimet e KRT-së përkatës, për miratimin e sheshit dhe të lejes së ndërtimit, në përputhje me ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, projektin teknologjik të instalimeve bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre (rezervuarët e magazinimit të produkteve dhe pajisjet përkatëse të trajtimit të tyre, infrastrukturën portuale detare (bovat, platformat, linjat, tubacionet etj.), së bashku me pajisjet që shërbejnë për transportimin e produkteve nga anijet për në depozita ose anasjelltas (pontili), të miratuar nga specialisti i licencuar në fushën e teknologjisë së instalimeve të naftës dhe të gazit, Këshilli i Rregullimit të Territorit në njësitë e qeverisjes vendore ku ndodhet zona e ndërtimit, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe nga Drejtoria MNZ-së;

- licencën e drejtuesit teknik të realizimit të projektit të instalimit bregdetar dhe të vënies së tij në përdorim;

- vërtetimin bankar se shoqëria në çastin e depozitimit të kërkesës ka një kapital minimal prej jo më pak se 300 000 000 (treqind milionë) lekësh.

Kapaciteti i stacionit të depozitave duhet të plotësojë këto kushte:

a) Për depozitimin dhe transportimin e naftës bruto e të karburanteve dhe të lëndëve djegëse e të lëngëta:

- kur bëhet për një kategori produkti jo më pak se 10 000 m³

- kur bëhet për dy kategori produkti jo më pak se 15 000 m³

- kur bëhet për më shumë se dy kategori produkti jo më pak se 20 000 m³

Në të gjitha rastet, sasia maksimale e kapacitetit depozitues për një subjekt, pavarësisht nga numri i produkteve që do të transportojë dhe depozitojë, nuk duhet t'i kalojë 40 000 m³.

- kapaciteti magazinues i një depozite nuk mund të jetë më i vogël se 2 000 m³.

b) Për depozitimin dhe transportimin e hazit të lëngshëm:

- kur bëhet për një kategori produkti (propan, butan etj) jo më pak se 1 000 m³
- kur bëhet për më shumë se një kategori produkti jo më pak se 2 000 m³

Në të gjitha rastet, sasia maksimale e kapacitetit depozitues për një subjekt, pavarësisht nga numri i produkteve që do të transportojë dhe do të depozitojë nuk duhet t'i kalojë 4 000 m³.

8. a) Shoqëria që ndërton dhe/ose shfrytëzon instalimet e reja bregdetare të transportimit dhe depozitimit të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre paraqet kërkesën e shoqëruar me projektet dhe me dokumentacionin përkatës, të plotësuar sipas pikës 7 të këtij vendimi, në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, e cila, pas verifikimit, i përcejell ato në Këshillin e Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli i Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Ujërave, pas shqyrtimit të projektit dhe të dokumentacionit shoqërues, bëjnë miratimin e sheshit të ndërtimit dhe të lejes së ndërtimit për pjesën tokësore dhe detare të instalimeve bregdetare, duke dhënë njëkohësisht edhe lejen për përdorimin e tokës.

Dokumentacioni i paraqitet Këshillit të Ministrave për dhënien e lejes së koncensionit, afati i së cilës do të jetë deri në 30 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

b) Leja e koncensionit duhet të përmbajë:

- numrin dhe datën e vendimit të Këshillit të Ministrave, nëpërmjet të cilit është bërë miratimi i lejes së koncensionit;

- numrin dhe datën e vendimit të Këshillit të Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet të cilit është bërë miratimi i kërkesës së shoqërisë për ndërtimin e instalimit bregdetar;

- emrin dhe selinë e shoqërisë që merr lejen e koncensionit, si dhe vendndodhjen e instalimeve bregdetare për të cilat jepet leja;

- llojin e lejes së tregtimit dhe afatin e saj, nëse shoqëria që do të ndërtojë dhe do të përdorë instalimet e reja bregdetare është e pajisur me leje tregtimi;

- afatin e vlefshmërisë së lejes së koncensionit dhe të drejtën për përsëritje;

- të drejtën e shoqërisë për transferimin e teknologjisë;

- afatin e përfundimit të ndërtimit të instalimit bregdetar dhe fillimin e vënies së tij në përdorim;

- të drejtën e shoqërisë të pajisur me leje koncensionit për të kërkuar shtyrjen e afatit të përfundimit të ndërtimit ose të vënies në përdorim të instalimit bregdetar, në rast të vendosjes së forcës madhore;

- të drejtën e organeve dhe të institucioneve shtetërore të ngarkuara me ligj për kontrollin e zbatimit të projektit nga shoqëria e pajisur me leje koncensionit, në cilësinë dhe afatin e përcaktuar në projekt;

- të drejtën e Këshillit të Ministrave për shfuqizimin e kësaj lejeje koncensionit, kur në kontrollin e ushtruar nga organet dhe institucionet shtetërore të ngarkuara me ligj janë vërejtur shkelje ose mosrespektime të detyrimeve themelore, sipas përcaktimeve në lejen e koncensionit;

- kategorinë e produktit të cilin do të depozitojë dhe transportojë shoqëria;

- llojin e detyrimeve financiare që do të ketë shoqëria ndaj shtetit dhe formën e pagimit të tyre;

- llojin dhe afatin e të dhënave që duhet të dërgojë shoqëria në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, në zbatim të urdhrit të ministrit përkatës.

c) Dokumenti i lejes së koncensionit përgatitet nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet, pasi për të të kenë dhënë mendim Ministria e Financave dhe ministria përgjegjëse për transportin detar. Ky dokument i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton lejen e koncensionit.

Leja e koncensionit hartohet në katër kopje, nga të cilat një kopje i dorëzohet zyrtarisht shoqërisë së cilës i jepet leja e koncensionit dhe nga një kopje arkivohet përkatësisht: në Këshillin e Ministrave, në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dhe në ministrinë përgjegjëse për transportin detar.

9. Subjektet, të cilët janë në marrëdhënie kontraktuale me shtetin për depozitat në Portin e Durrësit, do të kenë përparësi në kërkesën që mund të bëjnë për ndërtimin e impianteve dhe të depozitave bregdetare në sipërfaqet e miratuara sipas vendimit nr.251, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave.

10. Për vënien në përdorim të instalimeve të reja bregdetare, leja bëhet e vlefshme pas verifikimit të zbatimit të projektit nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës dhe Gazit, i cili, pasi

vëren se në këto instalime janë zbatuar kushtet dhe normat teknike, sipas legjislacionit në fuqi dhe të parashikuara në projektin e miratuar, jep vërtetimin përkatës, të miratuar nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, i cili i bashkëlidhet lejes së koncensionit.

11. Shoqëritë e pajisura me leje koncensionit për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare për depozitimin dhe transportimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre janë të detyruara të kenë në përdorim të pandërprerë instalimet e tyre bregdetare.

Këto shoqëri e realizojnë veprimtarinë e tyre për importimin, eksportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, nëpërmjet kontratës me shoqëritë e tregtimit me shumicë, që janë të pajisura me leje tregtimi, sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, për të cilat duhet të garantojnë furnizimin normal me produktet përkatëse.

Një kopje e kësaj kontrate depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Hidrokarbureve, brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së saj.

Kryerja e pagesave për ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve bregdetare për depozitimin dhe transportimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre, shlyerja e detyrimeve të tjera kontraktuale, si dhe çdo detyrim doganor dhe fiskal që lidhet me këto veprimtari bëhet nëpërmjet dokumentacionit bankar.

12. Në rast të mosplotësimit të kërkesave të këtij vendimi nga shoqëria e pajisur me leje koncensionit, ndaj saj zbatohen sanksione në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionin dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”.

Ankimi kundër sanksionit të vendosur nga organi përgjegjës shtetëror bëhet në përputhje me kushtet dhe me procedurat e parashikuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

13. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punëve Publike, Ministria e Transportit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M **Nr.360, datë 27.5.2001**

PËR PËRCAKTIMIN E BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 dhe 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Koeficientët e shtesës së bazës të vlerësuar vjetore, individuale, për llogaritjen fillestare të pensioneve, në mbështetje të pikës 3 të nenit 59 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 të jenë:

Për vitin 20001

Për vitin 19991x1.09=1.09

Për vitin 19981x1.05=1.14

Për vitin 19971x1.22x1.09=1.40

Për vitin 19961x1.09x1.22x1.05x1.09=1.52

Për vitin 19951x1.37x1.09x1.22x1.05x1.09=2.09

Për vitin 19941x1.32x1.37x1.09x1.22x1.05x1.09=2.75

2.Efektet financiare, si rrjedhojë e zbatimit të koeficientit të përcaktuar në pikën 1, të përballohen nga fondi i sigurimeve shoqërore, i programuar për vitin 2001.

3. Vendimi nr.159, datë 7.4.2000 i Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2001.

KRYEMINISRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 363, datë 27.5.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË TOKËS TRUALL QË PREKET NGA
NDËRTIMI I FUSHËS SË FUTBOLLIT NË QYTETIN E ÇOROVODËS DHE PËR DHËNIE
FONDI BASHKISË SË ÇOROVODËS PËR NDËRTIMIN E KËSAJ FUSHE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.1999 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik, në favor të Ministrisë së Pushtetit Vendor të pasurive të paluajtshme të pronarëve që preken nga ndërtimi i fushës së futbollit në qytetin e Çorovodës.

2. Pronarët e këtyre pasurive të paluajtshme të kompesohen me vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën e cila i bashkëlidhet këtij vendimi e që arrin shumën 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë.

3. Shpronësimi të fillojë me çeljen e fondit.

4. Bashkisë së Çorovodës, në buxhetin e miratuar për vitin 2001, t’i shtohet, në zërin “Investime”, fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milion) lekësh për ndërtimin e kësaj fushe.

5. Fondet për kompesimin e pronarëve dhe për ndërtimin e fushës së futbollit, që arrin vlerën e përgjithshme 25 500 000 (njëzetë e pesë milionë e pesëqind mijë) lekë, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Lista emërore e pronarëve që preken nga ndërtimi i fushës së sportit në qytetin e Çorovodës.

LLoji i pasurisë: tokë truall

1	2			3	4	5
Nr	Pronarë			Sipërfaqe	Çmimi	Vlera e truallit
				m2	lekë/m2	lekë /m2
	Emër	Atësi	Mbiemër			
1	Teki	Selam	Koprencka	325	1000	325 000
2	Mysel	Selam	Koprencka	1300	1000	1 300 000
3	Ylli	Selam	Koprencka	1462	1000	1 462 000

4	Namik	Selam	Koprencka	1527	1000	1 527 000
5	Faik	Selam	Koprencka	1886	1000	1 886 000
	Shuma			6 500	1000	6 500 000

V E N D I M
Nr.368,datë 27.5.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 243, DATË 20.4.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DETYRIMIN E LËSHIMIT TË KUPONAVE TATIMORË ME ANË TË ARKAVE REGJISTRUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 7 të vendimit nr. 243, datë 20.4.2001 të Këshillit të Ministrave bëhet ky ndryshim:
Në rreshtin e dytë, fjalët “deri më datë 30 qershor” zëvendësohen me “deri më 1 tetor”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 371, datë 27.5.2001

PËR PËRBALLIMIN E E FEKTEVE FINANCIARE NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.73, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përballimi i efekteve financiare për zbatimin e vendimit nr. 73, datë 15. 2. 2001 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, për vitin 2001, të bëhet si më poshtë:

a) 432 milionë lekë për përballimin e pagesave të trajtimit të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

b) 6.5 milionë lekë për komisionin e kryerjes së shërbimit, të administrimit, të caktimit dhe të pagimit, të trajtimeve të veçanta të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, nga Buxheti i Insitutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2001.

2. Në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2001, në zërin “Pagesa të parakohshme për minatorët” shtohet fondi prej 432 milionë lekësh.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.372, datë 27.5.2001

**PËR FILLIMIN E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT E TË RISTRUKTURIMIT DHE PËR
PËRCAKTIMIN E FORMËS E TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË
SHOQËRISË ANONIME “SERVCOM” FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 7, 8, 9 dhe 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të nenit 2 të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Servcom”, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit 8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria anonome “Servcom” Fier t’i nënshtrohet procesit të ristrukturimit të plotë.
2. Nga “Servcom” sh.a., të shkëputen Uzina Mekanike Patos dhe Parku i Mallrave Patos. Privatizimi i këtyre njësive do të bëhet në përputhje me legjislacionin e privatizimit të sektorëve jostrategjikë.
3. Fillimin e procedurave për privatizimin e “Servcom”, sh.a. Fier. Forma e privatizimit të shoqërisë të jetë ajo e transferimit të së drejtës së pronësisë të aksioneve të saj të tretëve.
4. Stuktura e formulës së privatizimit të aksioneve të kapitalit të shoqërisë të jetë si vijon:
 - a) Jo më pak se 51 për qind e aksioneve të kapitalit të ofrohen për t’u shitur në lekë. Shuma e aksioneve të mësipërme të kapitalit të transferohet nëpërmjet shitjes me tender të hapur.
 - b) Jo më shumë se 20 për qind e aksioneve të kapitalit t’u ofrohet punonjësve të shoqërisë me anë të shkëmbimit me bonot e privatizimit, dhënë atyre nga shteti. Procedura e transferimit të bëhet sipas vendimit nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, kapitulli B pika 1 deri 5, vetëm për punonjësit e shoqërisë. Si punonjës të “Servcom” sh.a. që përfitojnë nga pika “b”, quhen punonjësit në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000, si dhe punonjësit e njësive të kësaj shoqërie, të dalë në asistencë me vendimin nr.422, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave.
 - c) Ish-pronarëve të truallit t’u ofrohen aksione sipas vlerës së përfshirë në kapitalin e shoqërisë, në mbështetje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
5. Formula e privatizimit të aksioneve të kapitalit të shoqërisë dhe madhësia e paketave respektive përcaktohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
6. Punonjësit që dalin të tepërt nga procesi i ristrukturimit dhe i privatizimit të shoqërisë të cilët deri më datën 30.12.2000 kanë qenë në marrëdhënie pune, të trajtohen për 1 (një) vit me pagën bazë. Shpenzimet që nevojiten për pagat e këtyre punonjësve, të përballohen nga të ardhurat e privatizimit të kësaj shoqërie.
7. Periudha 1 (një) - vjeçare për këta punonjës të njihet si vjetërsi në punë për efekt pensioni dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.
8. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit ose të vetëpunësimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.
9. Kontributet e papaguara, së bashku me kamatëvonesat që “Servcom” sh.a. ka ndaj sigurimeve shoqërore deri në datën 30.12.2000, e që arrijnë vlerën 178.185.000 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, të shlyhen brenda 30 ditëve nga arkëtimet që do të realizohen nga privatizimi i shoqërisë.
10. Pagesa e punonjësve që dalin tepër nga zbatimi i këtij vendimi të bëhet nga zyrat e

punësimit në rrethet përkatëse, pas transferimit të fondit financiar nga “Servcom” sh.a.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 373, datë 27.5.2001

**PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS SË QEVERISË SHQIPTARE “PËR PËRGJEGJËSITË
E QEVERISË SHQIPTARE PËRKUNDREJT KËSHILLIT TË BYROVE, SIPAS
MARRËVESHJES UNIFORME TË BYROVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 23 të ligjit nr.8729, datë 18.1.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992, “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, për përgjegjësinë ndaj personave të tretë””, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Deklaratës së Qeverisë Shqiptare “Për përgjegjësitë e Qeverisë Shqiptare përkundrejt Këshillit të Byrove, sipas marrëveshjes uniforme të Byrove”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

DEKLARATË

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë deklaron se Byroja Shqiptare e Sigurimeve, themeluar në përputhje me rekomandimet e Gjenevës, Rekomandimin nr.5, adoptuar nga Grupi Kryesor i Punës për Transportet Rrugore të Komitetit të Transporteve Tokësore të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën më 25 janar 1949, zëvendësuar me Aneksin nr.2 të Rezolutës së Konsoliduar për Lehtësitë e Transporteve Rrugore, adoptuar nga Grupi Kryesor i Punës në sesionin e vet të datës 25-29 Qershor 1984, është në Shqipëri Byroja e cila përmbush kërkesat në përputhje me Marrëveshjen e Londrës të Sistemit të Kartonit Jeshil.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë pranon Kartonat Jeshile të lëshuar me autorizimin e Byrove Kombëtare, anëtare të Këshillit të Byrove.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të lejojë transferimin e lirë të valutave të huaja në vende të tjera, në mënyrë që të bëjë të mundur për Byronë Shqiptare të Sigurimeve të drejttojë dhe operojë Sistemin e Kartonit Jeshil, në përputhje me Marrëveshjen e Londrës.

4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë pranon që Byroja Shqiptare e Sigurimeve të bëhet anëtare e Këshillit të Byrove në Londër.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M
Nr.374, datë 27.5.2001

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.73, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË TË
PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pas pikës 1 të vendimit nr.73, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“ 1.1 Për efekt trajtimi sipas këtij ligji, punonjës që kanë punuar në miniera në nëntokë konsiderohen punonjës të ndërmarrjeve të ndërtim-minierave dhe të gjeologjisë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 376, datë 27. 5. 2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 612, DATË 29.12.1994 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DHËNIE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR DHE SHITESË
PENSIONI TË POSAÇËM “, NDRYSHUAR ME VENDIMET NR. 94, DATË 6.2.1995 DHE
NR. 635, DATË 27.2.1995 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës , të nenit 5 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit nr. 152, datë 5.4.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i punës dhe Çështjeve Sociale , Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në shkronjën “b” të pikës 1 të vendimit nr. 612, datë 29.12.1994 të Këshillit të Ministrave , fjalja e fundit ndryshohet si vijon :

“b) Shtesa e pensionit shtetëror të jetë 8 800 (tetë mijë e tetëqind) lekë në muaj.”

2. Efektet financiare shtrihen nga data 1.1.2001 dhe të përballohen nga fondet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore .

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 377, datë 31.5.2001

**PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” NË
MARËDHËNIET NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 24 e 31 të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një shteti tjetër ose një organizate ndërkombëtare, ndërmjet ministrive e institucioneve qendrore të vendit me homologët e tyre të vendeve të tjera, me të cilët janë lidhur marrëveshje ndërkombëtare, të bëhet në përputhje me këto marrëveshje.

2. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) pranë Këshillit të Ministrave është Autoriteti i Sigurimit Kombëtar në fushën e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” me NATON-n, me shtetet dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

3. Para nënshkrimit të një marrëveshjeje, e cila përmban shkëmbim të informacionit të klasifikuar, duhet që:

institucioni shtetëror shqiptar, që do të jetë palë në marrëveshje, të marrë më parë mendimin e DSIK-së;

pëlqimi për lidhjen e marrëveshjes për shkëmbim informacioni të klasifikuar jepet pasi Autoriteti i Sigurimit Kombëtar të vendit, palë në marrëveshje, të ketë dorëzuar te DSIK-ja garancinë se institucioni, që do të jetë palë në marrëveshje, do të ruajë informacionin e klasifikuar sipas standardit të kërkuar.

4. DSIK-ja u kërkon ministrive e institucioneve që lidhen me sigurimin kombëtar, rendin publik dhe institucioneve të tjera, që e gjykon të nevojshme, informacionin për besueshmërinë, veprimtarinë dhe qëndrimin ndaj vendit tonë të ministrisë apo të institucionit të shtetit palë në marrëveshje.

5. Certifikata e sigurisë e lëshuar nga Autoriteti i Sigurimit Kombëtar të shtetit palë në marrëveshje për një person apo organizëm, për të patur akses në informacionin e klasifikuar është e vlefshme vetëm kur është lidhur një marrëveshje ndërkombëtare.

6. Për ministrinë dhe institucionet qendrore të vendit tonë, që kanë lidhur ose do të lidhin një marrëveshje ndërkombëtare me homologët e tyre të huaj për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, DSIK-ja lëshon “Çertifikatë sigurie”. Certifikata e sigurisë lëshohet për një periudhë të nevojshme kohe, për aq sa kërkohet në marrëveshje dhe në bazë të vlerësimit të kushteve të sigurimit të informacionit të klasifikuar.

7. DSIK-ja nuk do të lejojë akses (pra t’u japë të drejtë njohjeje) personave të tretë për informacionin e klasifikuar, pa miratimin e Autoritetit të Sigurimit Kombëtar të informacionit të klasifikuar të vendit palë në marrëveshje.

8. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar ndërmjet NATO-s dhe Republikës së Shqipërisë do të drejtohet nga DSIK-ja. Informacioni i klasifikuar i NATO-s për Shqipërinë, për ministrinë, për institucionet qendrore dhe anasjelltas dërgohet në zyrën e Regjistrit Shtetëror (Qendror) të informacionit të klasifikuar, e cila ndodhet në DSIK, pranë Këshillit të Ministrave. Kjo zyrë bën regjistrimin, shpërndarjen dhe dërgimin e informacionit tek i adresuari.

9. Në Ministrinë e Mbrojtjes, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në Ministrinë e Rëndit Publik, në Misionin e Shqipërisë në NATO dhe në ministri e institucione të tjera qendrore, që kanë të bëjnë me informacionin e klasifikuar të NATO-s krijohet nënregjistri i informacionit të klasifikuar, i cili administron informacionin e klasifikuar që merr DSIK-ja.

Nënregjistri për administrimin e informacionit të klasifikuar zbaton rregulla të njëjta me ato të Regjistrit Shtetëror (Qendror).

10. DSIK-ja dhe Autoriteti i Sigurimit Kombëtar të shtetit palë në marrëveshje, në përputhje me marrëveshjen ndërkombëtare që kanë lidhur, kanë të drejtë të ushtrojnë kontrolle për mbrojtjen dhe

sigurimin e informacionit të klasifikuar në vendet respektive.

11. Për rastet e publikimit apo të njohjes nga persona të paaautorizuar të informacionit të klasifikuar, si dhe për rastet e vjedhjes, dëmtimit, shkatërrimit, humbjes, shkeljes së rregullave të sigurimit, etj. njoftohet, menjëherë, DISK-ja dhe Autoriteti i Sigurimit Kombëtar i shtetit palë në marrëveshje.

12. Për marrëveshjet dhe protokollet teknike të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, DISK-ja ka të drejtë të ushtrojë kontrolle për mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer.

13. Ministrinë dhe institucionet qendrore janë të detyruara që një kopje të marrëveshjes për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar t'ia dërgojnë DISK-së.

14. Ngarkohen titullarët e ministrive, institucioneve qendrore dhe DISK-se për zbatimin e këtij vendimi.

15. Përfshihen nga zbatimi i këtij vendimi shërbimet informative brenda vendit, të cilat, në marrëdhënie me shërbimet e huaja partnere, zbatojnë procedurat për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, sipas marrëveshjes që kanë lidhur.

16. Vendimi nr.228, datë 4.4.1998 i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e Autoritetit Kombëtar për shkëmbimin e informacionit me NATO-n" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M **Nr. 378, datë 31.5.2001**

PËR VAZHDIMIN E DHËNIES SË KREDISË PËR DISA FAMILJE TË PASTREHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Familjet e pastreha, të cilat kanë përfituar kredi të pjesshme për ndërtimin banese nga Banka Bujqësore, të trajtohen me kredi për përfundimin e punimeve të ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave.

2. Lista e familjeve dhe masa e kredisë përcaktohen në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Enti Kombëtar i Banesave, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe nga Bashkia e Tiranës, të kryejë veprimet përkatëse pasi të ketë bërë verifikimin në vend të punimeve të kryera në përputhje me dokumentacionin tekniko-ekonomik, brenda fondit të miratuar.

4. Efektet financiare prej 5 343 700 (pesë milionë e treqind e dyzet e tre mijë e shtatëqind) lekësh të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001, në zërin "Ndërtim banese", i Ministrisë së Punëve Publike për Entin Kombëtar të Banesave.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA E FAMILJEVE
SIPAS PREVENTIVAVE TË HARTUARA NGA KOMISIONI I PUSHTETIT VENDOR

1. Ismail Jonuzi	901 095 lekë
2. Xhevdet Emini	1 301 660 lekë
3. Astrit Mali	2 198 570 lekë
4. Kujtim Sula	941 377 lekë

SHUMA	5 342 700 lekë
-------	----------------

V E N D I M
Nr.379, datë 31.5.2001

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË RADIOFREKUENCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 70, 71 dhe 72 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin, publik e privat, në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Planit kombëtar të radiofrekuencave”, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Adiministrimi dhe përdorimi i radiofrekuencave të bëhet në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë plan kombëtar.
 3. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, me fondet e veta dhe brenda vitit 2002, të ngrejë “Qendrën Kombëtare të Mbikqyrjes së Radiofrekuencave” për shmangien e interferencave dhe shfrytëzimin e frytshëm të të gjithë spektrit të radiofrekuencave.
 4. Institucionet përgjegjëse për administrimin e radiofrekuencave të ndërmarrin veprimet që parashikohen në shtojcën nr.1 të “Planit kombëtar të radiofrekuencave” për të bërë përputhjen e këtij plani me përcaktimin e përbashkët europian.
 5. Krijimin, brenda vitit 2001, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Postë-Telekomunikacioneve, të sistemit bazë të të dhënave për radiofrekuencat për azhurnimin e “Planit kombëtar të radiofrekuencave” me standardet ndërkombëtare.
 6. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve dhe Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit të vënë në dispozicion të publikut, në formë të shkruar ose elektronike, në çdo kohë, gjendjen e brezave të radiofrekuencave që kanë në administrim.
 7. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve të plotësojë kërkesat e Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit për radiofrekuencë, për shërbimin fiks dhe të lëvizshëm, për nevojat e operatorëve të radios dhe atyre televizivë, brenda një muaji nga paraqitja me shkrim e kërkesës.
 8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve për publikimin e “Planit kombëtar të radiofrekuencave”, me përjashtim të shtojcës nr.7 të tij.
 9. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Postë-Telekomunikacioneve, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.
 10. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.380, datë 31.5.2001

**PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” NË
FUSHËN INDUSTRIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Institucionet shtetërore, të cilat, për nevoja të realizimit të detyrave duhet të hyjnë në marrëdhënie me subjekte shtetërore, private, me institucione kërkimore-shkencore etj., vendase ose të huaja për realizimin e projekteve dhe planeve shkencore, teknologjike dhe ekonomike, që kanë lidhje me sigurinë kombëtare dhe përbëjnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, duhet t’u kërkojnë atyre “certifikatën e sigurisë industriale”.

2. Të drejtën për të lëshuar këtë certifikatë e ka Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) pranë Këshillit të Ministrave.

3. Lëshimi i certifikatës bëhet pasi kryhet verifikimi i kontraktuesit.

II. Kushtet që duhet të përmbajë kontrata

Përveç kushteve të përcaktuara me aktet e tjera normative në interes të sigurimit dhe të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kontrata duhet të përmbajë:

a. kërkesat e hollësishme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të detyrueshme për kontraktuesin, si dhe pasojat në rast shkeljeje;

b. nivelin e klasifikimit të kontratës, i cili duhet të jetë i njëjtë me nivelin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, që përfshihet në kontratë;

Kur përfshihen me shumë se një nivel klasifikimi kontrata merr nivelin e klasifikimit më të lartë.

c. personat përgjegjës për mbikëqyrjen, inspektimin, trajnimin dhe këshillimin e personelit, i cili merr pjesë në njohjen, në zbatimin apo në çdo fazë tjetër që lidhet me realizimin e kontratës së klasifikuar.

III. Detyrime për kontraktuesin

Kontraktuesi është i detyruar:

1. të ruajë informacionin e klasifikuar gjatë fazës së parakontratës, kur zhvillohen bisedime dhe bëhen përpjekje për lidhjen e saj. Detyrimi për ruajtjen e informacionit të klasifikuar vazhdon dhe pas përfundimit të kontratës, për aq kohë sa informacioni është i klasifikuar;

2. të njoftojë institucionin shtetëror dhe personat përgjegjës, për çdo rast të njohjes me informacionin e klasifikuar të personave të paautorizuar, në çfarëdo forme qoftë, si dhe në rast vjedhjeje, dëmtimi, shkatërrimi etj;

3. të caktojë personat përgjegjës për zbatimin e masave të sigurisë;

4. të verë në dijeni institucionin shtetëror për çdo ndryshim strukturor ose për çdo ndryshim të personelit që lidhet me realizimin e kontratës për të marrë miratimin e tij;

5. të mos realizojë kontratën ose pjesë të saj me nënkontraktues, pa marrë më parë miratimin e institucionit shtetëror. Për nënkontraktuesin zbatohen të njëjtat procedura si me kontraktuesin;

6. të krijojë, në çdo kohë, kushtet dhe lehtësitë për inspekte, të planifikuara ose jo, të përfaqësuesve të institucionit shtetëror ose DSIK-së në lidhje me kontratën;

7. të përgjigjet, brenda afatit, për kushtet e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, sa herë e kërkon institucioni shtetëror;

8. të krijojë kushte për trajnimin e personelit që merret me realizimin e kontratës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” nga përfaqësuesit e institucionit shtetëror ose nga DSIK-ja.

IV. Procedurat e verifikimit

A. Për kontraktuesin

1. DSIK-ja realizon procedurat për verifikimin e pastërtisë së kontraktuesit. Institucioni shtetëror, i interesuar për lidhjen e kontratës, para se ta lidhë atë, duhet t'i paraqesë DSIK-së kërkesën për verifikimin e pastërtisë së kontraktuesit. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet e këtij verifikimi dhe të shoqërohet me:

a. deklaratën e pronarit ose të pronarëve të subjektit privat, ku pranohet që të mblidhen të dhëna dhe të bëhen verifikime ndaj subjektit. Modeli i deklaratës përcaktohet nga DSIK-ja.

b. deklaratën për ruajtjen e sekretit shtetëror, sipas modelit të përcaktuar nga DSIK-ja;

c. pyetësin e sigurisë industriale, të plotësuar sipas udhëzuesit përkatës, por të përcaktuar nga DSIK-ja.

Kur kontraktuesi është institucion shtetëror, kërkesa shoqërohet vetëm me pyetësin e sigurisë industriale.

2. Kërkesa bëhet vetëm pasi institucioni kërkues ka realizuar verifikimin paraprak, sipas pyetësit të sigurisë industriale dhe është dakord për lidhjen e kontratës.

3. DSIK-ja, në bazë të këtij verifikimi dhe në bazë të propozimit të titullarit të institucionit, pasi përfundon verifikimin dhe e vlerëson në përputhje me ligjin dhe aktet e tjera normative, lëshon certifikatën e sigurisë industriale.

Afati për kthimin e përgjigjes nga DSIK-ja është 2 muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës. Në rast të mosrespektimit të këtij afati, DSIK-ja duhet të njoftojë institucionin kërkues për shkaqet e vonësës.

4. Institucionet, të cilave me ligj u është njohur e drejta për të bërë verifikime për këtë qëllim, zbatojnë procedurat e përcaktuara në këtë vendim dhe pasi janë shprehur dakord, i kërkojnë DSIK-së lëshimin e certifikatës së sigurisë industriale.

5. DSIK-ja, në bazë të kërkesës së dokumentacionit të paraqitur nga institucioni kur i gjen të plota, u kërkon të dhëna që lidhen me verifikimin e kontraktuesit institucioneve përkatëse, që kanë lidhje me sigurimin kombëtar, rendin kushtetues, rendin publik, organeve të drejtësisë, ministrive e institucioneve të tjera shtetërore a subjekteve private.

6. DSIK-ja, në rastet kur kontraktuesi është ndërmarrje e huaj, ndërmarrje e përbashkët ose shumëkombëshe, komunikon me Autoritetin e Sigurimit Kombëtar të vendeve përkatëse për të bërë, sipas marrëveshjes, verifikimin.

7. Procesi i shqyrtimit të pastërtisë së kontraktuesit bëhet sipas pyetësit të sigurisë industriale.

8. DSIK-ja, në përfundim të procedurës së verifikimit, kur e gjen të bazuar, lëshon certifikatën e sigurisë industriale, e cila vërteton se kontraktuesi është i aftë ta mbrojë informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

9. Dhënia ose futja me qëllim e informacioneve të rreme në pyetësin e sigurisë industriale përbën shkak për moslëshimin e certifikatës së sigurisë industriale.

10. DSIK-ja, në rast moslëshimi të certifikatës së sigurisë industriale, vë në dijeni institucionin kërkues.

Në këtë rast institucioni kërkues ose dhe kontraktuesi kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve te Kryeministri, vendimi i të cilit është përfundimtar.

11. Procedura e verifikimit për një kontraktues, të cilit nuk i është pranuar kërkesa për pajisjen me certifikatë të sigurisë industriale, mund të rifillojë pas kalimit të një periudhe 6-mujore deri në një vit nga data e mospranimit, duke vlerësuar shkaqet që kanë sjellë këtë.

12. Certifikata e sigurisë industriale është e vlefshme për aq kohë sa duhet për realizimin e kontratës.

13. Niveli i certifikatës së sigurisë industriale lëshohet sipas nivelit të informacionit të klasifikuar që përmban kontrata.

B. Për personelin e kontraktuesit

1. Personeli i kontraktuesit, që do të marrë pjesë në realizimin e çdo faze të kontratës dhe që do të njihet me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i nënshtrohet procedurës së verifikimit të pastërtisë së figurës.

2. Procesi i shqyrtimit të pastërtisë së figurës dhe lëshimi i certifikatës së sigurisë për personelin e kontraktuesit, që do të marrë pjesë në realizimin e kontratës, bëhet në mbështetje të vendimit nr.122, datë 15.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e certifikatës së sigurisë personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

V. Pyetësoni i sigurisë industriale

Pyetësoni i sigurisë industriale duhet të përmbajë:

1. informacion për statusin ligjor të kontraktuesit;
2. informacion për strukturat dhe kapitalin e kontraktuesit;
3. informacion për trupën administrative, për punonjësit që do të marrin pjesë në realizimin e kontratës dhe supervisorët;
4. informacion për sistemin e mbrojtjes dhe masat e sigurisë për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, që do t’i besohet gjatë realizimit të kontratës;
5. informacion nëse ka marrë pjesë më parë në realizimin e kontratave të klasifikuara, brenda ose jashtë vendit;
6. specifikimin e punonjësve të autorizuar që do të kenë të drejtë të njihen me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;
7. personin ose personat përgjegjës, të autorizuar nga drejtuesi i kontraktuesit për marrjen e masave për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, gjatë gjithë fazave të realizimit të kontratës.

DSIK-ja, në zbërthim dhe plotësim të kërkesave të mësipërme, mund të pasqyrojë në pyetësonin e sigurisë industriale edhe kërkesa të tjera.

VI. Rregulla të veçanta

1. Dokumentacioni i grumbulluar për kontraktuesit ruhet pranë DSIK-së.
 2. Kur DSIK-ja e gjykon të nevojshme, praktikën e këtij dokumentacioni mund t’ua dërgojë për ruajtje dhe administrim institucioneve shtetërore kërkuese, të cilat, me ligj, kanë të drejtë të bëjnë verifikimin e kontraktuesit.
 3. Ngarkohen ministritë e insitucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet DSIK-ja me kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit të Fletores Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr. 382, datë 31.5.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SISTEMIT RRUGOR SUKTH –DURRËS, NË
TERRITORIN E QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 5 të neneve 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Sukth – Durrës në territorin e qarkut të Durrësit.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të konpensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe të përgjithshme 378 m2 tokë /arë, 187 m2 objekte ndërtimi, vlerësuar me shumën e përgjithshme prej 5 082 100 (pesë milionë e tetëdhjetëdy mijë e njëqind) lekësh.
4. Ky fond, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2001, në zërin “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit.
5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.6.2001.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Fshati Shenavlash

Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të superstradës Vorë-Durrës, seksioni Sukth – Durrës

Lloji i pasurisë: tokë bujqësore (nr.1-2)

Nr.	Emër Atësia Mbiemër	Nr.i pasurisë	Sip. m2	Vlera në m2	Vlera totale në lekë
1	Bajram Nustret Sadiku	284/49	108	1200	129600
2	Isak Rasim Brahaj	290/36	63	1200	75600
3	Muharrem Rustem Hoxha		207	1200	284400
	Shuma:				

Mbyllet me numër rendor 3 (tre)

Lloji i pasurisë: ndërtesë (nr.1-2)

Nr	Emër Atësia Mbiemër	Nr.i pasurisë	Sip. m2	Vlera në m2	Vlera totale në lekë
1	Bajram Nustret Sadiku	284/49	46	23.500	1016140
2	Qemal Shaqir Loga	290/72	141	23.500	3048400
	Shuma:				

Mbyllet me numër rendor 2 (dy)

Shpenzimet e procedurës së shpronësimit (Publikime) për të gjithë këtë segment rrugor nga Sukthi në Durrës kapin vlerën prej 563500 lekë.

V E N D I M
Nr. 385, datë 31.5.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kopetencat e përcaktimit të pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” bëhen këto ndryshime:

a) Në klasifikimin “A4” shtohet funksioni “Kryetar i Bashkisë së Tiranës” dhe shfuqizohet ky funksion në klasifikimin “A9”.

b) Në klasifikimin “A10” shtohet funksioni “Zëvendëskrytar i Bashkisë së Tiranës” dhe shfuqizohet ky funksion në klasifikimin “B3”.

c) Në klasifikimin “B2” shtohet funksioni “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme në Bashkinë e Tiranës” dhe funksioni “Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Bashkiak të Tiranës” dhe shfuqizohen këto funksione nga klasifikimi “B4”.

Në klasifikimin “B2”, shtohet funksioni “Drejtor Kabineti i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës”.

d) Në funksionin “B3” shtohet funksioni “Drejtor Drejtorie në Bashkinë e Tiranës” dhe

funkcioni “Këshilltar pranë Kryetarit të Bashkisë së Tiranës”.

2. Lidhja II –17 me emërtimin “Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e Bashkisë së Tiranës” zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001, për Bashkinë e Tiranës.

4. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

LIDHJA II-17
NIVELI I PAGËS PËR PUNONJËSIT BASHKISË SË TIRANËS

Nr	Emërtimi	Klasifikimi	Shtesa për funksion
1	Kryetar	A4	
2	Zëvendëskryetar	A10	
3	Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Bashkiak	B2	
4	Drejtor i Përgjithshëm	B2	
5	Drejtor Kabineti	B2	
6	Drejtor drejtorie	B3	
7	Këshilltar i Kryetarit	B3	
8	Përgjegjës sektori	IX	
9	Përgjegjës zyre	VIII	
10	Sekretar i Drejtorit të Përgjithshëm	VI	
11	Specialist i	VIII	
12	Specialist II	VII	
13	Sekretar i Drejtorit	VI	
14	Arkivist	VI-VI	
15	Sekretar i Kryetarit të Bashkisë	VI	
16	Sekretar i Kryetarit të Këshillit Bashkiak	VI	
17	Shofer, daktilografist	IV	
18	Punëtor	II-IV	
19	Pastrues	i	
20	Supervizor	VIII	

V E N D I M
Nr.387,datë 31.5.2001

**PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DHE TATIMET TË INVALIDËVE PARAPLEGJIKË
DHE TETRAPLEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 6,16 dhe 21 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për efekt të zbatimit të nenit 6 të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga këto taksa:

Taksat për shërbimet konsullore;

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve;

- Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti;
- ç) Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive;
 - d) Taksa për përdorimin e aparateve telefonikë;
 - dh) Taksa për regjistrimin në arsimin e lartë;
 - e) Taksa për kalimin e kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion;
 - ë) Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi;
 - f) Taksa për pastrimin, largimin dhe kompostimin e mbeturinave;
 - g) Taksa për gjuetinë dhe peshkimin amator;
 - gj) Taksa e solidaritetit për rendin dhe mbrojtjen.
2. Mjetet që u përkasin të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që përfitojnë nga përjashtimi i detyrimeve të importit janë:
- a) Pajisje të thjeshta të përdorimit vetjak të të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
 - b) Karroca me dhe pa motor, si dhe autovetura të përshtatura për përdorimin nga këta të sëmurë.
- Procedurat e përjashtimit nga detyrimet e importit të këtyre mjeteve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës e të Shërbimeve Sociale dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganeve.
3. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M

Nr.397,datë 31.5.2001

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në reshtin e 6-të të pikës 19, pas emërimit “Pedagog me gradë shkencore”, shtohet emërtimi “Kërkues me gradë shkencore”.
2. Në lidhjen 1 “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” bëhen këto ndryshime:
 - a) Në klasifikimin “A8” shtohen emërtimet “Zëvendëskryetar në Akademinë e Shkencave, Sekretar shkencor në Akademinë e Shkencave” dhe këto emërtime në klasifikimin “A12” shfuqizohen.
 - b) Në klasifikimin “B5” shtohet emërtimi “Kërkues me gradë shkencore” dhe në klasifikimin “C2” Shtohet emërtimi “Kërkues”.
3. Në lidhjen II-8 “Niveli i pagës për punonjësit e Akademisë së Shkencave” bëhen këto ndryshime:
 - a) Numri rendor 2 zëvendësohet me këto emërtime: “Zëvendëskryetar, Sekretar shkencor, klasifikimi “A8”.
 - b) Numri rendor 3 zëvendësohet me emërtimin “Kërkues me gradë shkencore, klasifikimi “B5””.
 - c) Shtohet numri rendor 3/1, me emërtimin “Kërkues”, klasifikimi “C2” dhe ky emërtim në

numrin rendor 6 shfuqizohet.

d) Në numrin rendor 5 shtesa për funksion bëhet grupi 5.

4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001 për Akademinë e Shkencave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr. 399, datë 31.5.2001

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE NË SHËRBIMIN INFORMATIV KOMBËTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar” dhe të nenit 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.56, datë 27.2. 1992 të Këshillit të Ministrave, në pasqyrën e shtesave mbi pagën bazë, për punonjësit e Shërbimit Informativ Kombëtar, që i bashkëlidhet vendimit, në pikën 2, shtesa për vështirësi vendi dhe zone bëhet “deri në 50 për qind të pagës mujore”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001 për Shërbimin Informativ Kombëtar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr.402, datë 11.6.2001

PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7392, DATË 17.5.1995; NR.8286, DATË 16.2.1998; NR. 8392, DATË 2.9.1998; NR. 8575, DATË 8.2.2000; NR. 8776, DATË 26.4.2001 DHE TË LIGJIT NR.7880, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. SIGURIMI I DETYRUESHËM

Në mbështetje të neneve 2 dhe 9 të ligjit nr. 7703 datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 4 dhe 8 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, quhen persona të mbrojtur:

1. Të punësuarit me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar, të punësuarit me kontratë pune pa afat më shumë se një maj e që punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme në punë për më shumë se 24 orë në javë, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për paaftësi të përkohshme në punë, në periudhë shtatzanie e të paslindjes, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësinë dhe sigurim shëndetësor.

2. Të punësuarit me kontratë pune me ose pa afat, por që punojnë për kohë të pjesshme pune, që zgjat më pak se 24 orë në javë, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për nivel minimal, për periudhën e shtatzanisë e të paslindjes, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor.

3. Të punësuarit me kontratë pune me afat më pak se një muaj gjatë vitit, me kohë të plotë ose të pjesshme pune, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor.

4. Personat ekonomikisht aktivë (punëdhës dhe të vetëpunësuar) që ushtrojnë veprimtari ekonomike pavarësisht nga kohëzgjatja e saj, të cilët sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, për periudhën e shtatzanisë e të paslindjes, pensione dhe sigurim shëndetësor.

5. Të vetëpunësuarit në bujqësi, kur janë të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 deri në 60 vjeç për meshkujt dhe 16 deri në 55 vjeç për femrat dhe nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për periudhën e shtatzanisë e të paslindjes, për pensione dhe sigurim shëndetësor.

6. Pjestarët e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me punëdhënësin, privat dhe të vetëpunësuarin, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme në nivel minimal, për periudhë shtatzanie e të paslindjes, pensione dhe sigurim shëndetësor.

7. Personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, mbi 16 vjeç, paguajnë vetëm për sigurimin shëndetësor.

II. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në bazë të neneve 2,32, 36 dhe 48 të ligjit nr. 7703 datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", shuma bazë e përfitimit nga data 1.7.2001 e në vazhdim është 5 560 lekë në muaj.

2. Në zbatim të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, për personat që nuk plotësojnë kushtet për përfitim të masës së pensionit të përcaktuar nga paragrafi i parë i këtij neni, shuma bazë e përfitimit nga 1.7.2001 e në vazhdim është 1 726 lekë në muaj.

III. LLOJET, SHUMA DHE SHPËRNDARJA E KONTRIBUTEVE

Në zbatim të neneve 9,10,14 dhe 90 të ligjit nr. 7703 datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 8,9,10,11 dhe 12 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", llojet dhe masa e kontributeve përcaktohen:

1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën 1.7.2001 e në vazhdim është 3 854 lekë. Kontributi minimal mujor sipas degëve të sigurimit është:

	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	126
Dega e sigurimit për periudhën e shtatzanisë e të paslindjes	235
Dega e sigurimit të pensioneve	2662
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	42
Dega e sigurimit të papunësisë	504
Sigurimet shëndetësore	285

2. Për të punësuarin, punëdhënësi derdh kontribute të detyrueshme në masën 45.9 për qind të pagës mujore, sipas listë – pagesave. Nga data 1.7.2001 e në vazhdim, paga minimale mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është 8 396 lekë, ndërsa paga maksimale përcakohet 25 188 lekë.

3. Punëdhënësi privat, i vetëpunësuar, të vetëpunësuarit në ortakëri, që ushtrojnë veprimtari ekonomike (përfshirë të vetëpunësuarin në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2001 e në vazhdim, derdh për vete kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 41.5 për qind të pagës mujore minimale prej 8 396 lekësh.

4. Pjesëtarët e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me punëdhënësin privat dhe të vetëpunësuarin (përfshirë të vetëpunësuarin në bujqësi), duke filluar nga 1.7.2001 e në vazhdim derdhen kontribut për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në mënyrë të detyrueshme, në masën 41.5

për qind të pagës mujore minimale prej 8 396 lekësh.

5. Personat mbi 16 vjeç me të ardhura të rregullta nga pronësia e që nuk kanë ndonjë punësim tjetër, duke filluar nga 1.7.2001 e në vazhdim, paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor në masën 7 për qind të pagës mujore minimale 8 396 lekë.

6. Të vetëpunësuarit në bujqësi derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore në masën 15 për qind të të ardhurave fikse vjetore prej 10 800 lekësh, me përjashtim të rretheve, Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilat masa e kontributit vjetor do të jetë 9 për qind e të ardhurave fikse prej 10 800 lekësh.

Të vetëpunësuarit në bujqësi mund të paguajnë ata vetë kontributet e detyrueshme për sigurimet shëndetësore, pavarësisht nga pagesa e kontributeve për sigurimin shoqëror. Masa e kontributit është 5 për qind e pagës minimale mujore prej 900 lekësh. Bëhet përjashtim për rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë e Tropojë, për të cilat masa e kontributit është 3 për qind e pagës minimale mujore prej 900 lekësh.

IV. PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN NË SIGURIMET SHOQËRORE E SHËNDETËSORE

Në zbatim të neneve 13, 14, 15, 79, 81, dhe 82 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 9 dhe 11 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, për regjistrimin në organet e sigurimeve shoqërore duhet që:

1. Çdo person juridik ose fizik fiton të drejtën të fillojë veprimtari ekonomike vetëm pasi të regjistrohet në gjykatë. Pas këtij regjistrimi ai detyrohet të kërkojë regjistrimin në organet e sigurimeve shoqërore. Kërkesa për regjistrim depozitohet në organet e sigurimeve shoqërore të qarkut ku personi ka selinë apo njësinë e veprimtarisë dhe shoqërohet me një kopje të noterizuar të vendimit të gjykatës, me certifikatën e gjëndjes civile, me fotografi të personit ose ortakëve, me një deklaratë për njësitë, degët ose filialet e veprimtarisë së tij dhe vendodhjen e tyre, si dhe me vërtetimin e regjistrimit në zyrat e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës.

Të gjithë personat juridikë e fizikë janë të detyruar të njoftojnë në organet e sigurimeve shoqërore, ndryshimin e emrit të subjektit, ndryshimin e selisë së veprimtarisë, ndryshimin e emrit dhe të adresës së filialeve, të degëve, e të njërive, krijimin e degëve, filialeve ose njërive të reja dhe ndryshimin e llojit të veprimtarisë ekonomike.

Organet e sigurimeve shoqërore përpunojnë të gjitha kërkesat për regjistrim fillestar brenda dy ditëve nga data e marrjes së kërkesës dhe e pajisin personin me një dokument tip, i cili vërteton regjistrimin në këto organe.

2. Personat juridikë privatë ose personat fizikë, për të fituar të drejtën e vazhimit të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike për vitin e ardhshëm kalendarik, detyrohen të regjistrohen në organet e sigurimeve shoqërore.

a) Personat juridikë e fizikë, me xhiro vjetore nën kufirin e regjistrimit në TVSH detyrohen të regjistrohen në organet e sigurimeve shoqërore deri në datën 28 shkurt të çdo viti.

b) Personat juridikë e fizikë që regjistrohen në TVSH detyrohen të regjistrohen në organet e sigurimeve shoqërore deri në datën 31 mars të çdo viti.

Mosparaqitja për regjistrim dhe reregjistrimin nuk e përjashton personin nga përgjegjësia për llogaritjen dhe pagimin e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore.

Organet tatimore nuk i regjistrojnë dhe i reregjistrojnë personat, juridikë e fizikë, nëse ata nuk paraqesin dokumentin e regjistrimit në organet e sigurimeve shoqërore. Dokumenti i regjistrimit në këto organe shoqërohet edhe me vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të vitit pararendës.

3. Punëdhënësi bën sigurimin e punëmarrësit, duke filluar nga dita e fillimit të punës, në bazë të një kontrate pune ose aktemërimi dhe e vazhdon sigurimin e punëmarrësit gjatë gjithë kohës që ky i fundit është në marrëdhënie pune.

Punëdhënësi është i detyruar të deklarojë në sigurimet shoqërore numrin e të punësuarve, pagën e tyre, si dhe ndryshimet e numrit të të punësuarve dhe të pagës së tyre gjatë vitit.

Ndërprerjet e punës ose ditët e munguara në punë vërtetohen me raporte mjekësore dhe me anë të dokumentacionit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. (Kodi i Punës, Statusi i Nëpunësit

Civil etj). Për këto, punëdhënësi bën shënimet përkatëse në regjistrin e pagave dhe të derdhjes së kontributeve. Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, për efekt të kontrollit të zbatimit të kufijve, minimalë e maksimalë, të pagave, bëhet në proporcion me kohën e punuar.

4. Për punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit, periudha e detyrimit ndaj sigurimeve shoqërore nis ditën kur personi ka filluar ligjërisht veprimtarinë ekonomike dhe mbaron ditën kur ligjërisht përfundon kjo veprimtari.

Fillim i ligjshëm i veprimtarisë ekonomike quhet data e regjistrimit në organin tatimor. Për këtë personi pajiset me certifikatën përkatëse.

Ndërprerja e veprimtarisë ekonomike gjatë vitit kalendarik, vërtetohet me dokumentacionin e organeve të tatim taksave, ndërsa mbyllja e veprimtarisë vërtetohet me vendim gjykate.

5. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore për vitin në vazhdim, pavarësisht nëse janë të pasiguruar për vitet pararendëse. Periudhat për të cilat nuk janë paguar kontributet nuk njihen si periudha sigurimi.

Përjashtohen nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror familjet e të vetëpunësuarve në bujqësi, që përfitojnë nga ligji nr. 7710, datë 18.5.1995 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”. Periudhat gjatë të cilave përfitohet nga ky ligj nuk njihen si periudha sigurimi.

V. PAGESA E KONTRIBUTEVE

Në zbatim të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të neneve 8, 9 dhe 11 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, punëdhënësi detyrohet të derdhë çdo muaj në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore kontributet e sigurimeve shoqërore dhe ato shëndetësore.

Për personat e punësuar, punëdhënësi mban nga paga mujore e tyre kontributin e sigurimeve shoqërore prej 11.7 për qind dhe bashkë me pjesën e tij prej 34.2 për qind, në kufijtë e pagës, minimale dhe maksimale, të përcaktuar në këtë vendim, i derdh çdo muaj në llogaritë e sigurimeve shoqërore. Afati i pagesës së kontributeve të llogaritura mbi pagat e muajit pararendës është jo më vonë se dita e fundit e muajit pararendës. Derdhja e kontributit të sigurimeve shoqërore bëhet me urdhër-xhirimi tip “Për sigurimet shoqërore”. Punëdhënësi detyrohet të paraqesë çdo muaj në agjencitë e sigurimeve shoqërore të qarkut listën emërore të punonjësve, pagën mujore, pagën mbi të cilën është derdhur kontributi dhe masën e kontributit të derdhur për çdo të punësuar.

Punëdhënësi pajis të punësuarit e vet me “Librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” dhe i plotëson ato çdo muaj në datën e pagimit të pagës për pesëmbëdhjetëditëshin e dytë të muajit. Pas datës 1.1.1994, vjetërsia në punë dhe shuma e kontributeve të paguara nga çdo person ekonomikisht aktiv vërtetohet me librezën e kontributeve.

Kontributet e sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nga punëdhënësit, të vetëpunësuarit dhe të vetëpunësuarit ortakë paguhet në llogaritë e sigurimeve shoqërore me urdhër-xhirimi tip një herë në tre muaj. Afati i pagesës së kontributeve është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore i paguajnë vetë një herë në tre muaj. Afati i pagesës së kontributeve është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

Detyrimi ndaj sigurimeve shoqërore llogaritet nga administrata e sigurimeve shoqërore për kontributet e papaguara brenda afateve të përcaktuara më lart. Pas datës 1.1.2001 e në vazhdim, detyrimi ndaj sigurimeve shoqërore përfaqëson shumën e kontributeve të papaguara brenda afateve ligjore dhe shumën e kamatë – vonesave, të llogaritura mbi kontributet e paderdhura brenda afateve ligjore, gjatë vitit të mëparshëm.

Detyrimi ndaj sigurimeve shoqërore, në fillim, llogaritet në bazë të deklarimit fillestar të subjektit ose në bazë të listë –pagesave të dorëzuara në organet e sigurimeve shoqërore për muajin pararendës. Ky detyrim saktësohet dhe mbetet përfundimtar pas kryerjes së akt-rakordimit ndërmjet përfaqësuesit të subjektit dhe administratës së sigurimeve shoqërore dhe nxjerrjes së akt –detyrimit. Akti i detyrimit nxirret nga administrata e sigurimeve shoqërore jo më vonë se dy muaj nga data e kalimit të afatit ligjor të pagesës së kontributeve dhe i njoftohet subjektit zyrtarisht.

VI. TË ARDHURAT MBI TË CILAT PAGUHEN KONTRIBUTET

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të nenit 10 të ligjit nr. 7870, datë 11.5.1994, të ardhurat mbi të cilat llogariten e paguhet kontributet janë:

1. Paga që jep punëdhënësi, e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale dhe më e

madhe se paga maksimale, e përcaktuar në pikën II të këtij vendimi.

2. Të ardhurat nga një punë e dytë ose nga një punë tjetër, të cilat raportohen te punëdhënësi kryesor dhe kontributet që rrjedhin prej tyre, nuk duhet të tejkalojnë pagën maksimale, të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi.

3. Të ardhurat nga vetëpunësimi, pavarësisht nëse personi është i punësuar. Në rastet kur personi është i punësuar te një punëdhënësi dhe, njëkohësisht, është i vetëpunësuar, kontributet do të paguhen si i punësuar dhe për diferencë si i vetëpunësuar, deri në pagën maksimale, të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi.

Nuk quhen të ardhura nga veprimtaria ekonomike dhe nuk u nënshtrohen kontributeve:

- përfitimet nga ligji i sigurimeve shoqërore;
- konpensimet nga rritja e çmimeve;
- dhuratat;
- të ardhurat nga detyrimi për ushqim sipas Kodit Civil;
- shpërblimet nga fondi i veçantë.

VII. SIGURIMI I PAPUNËSISË

Në kuptim të neneve 53, 54, 55, 57, 84 e 85 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, për të përfutur të ardhura nga papunësia duhet që:

1. Personat e siguruar të regjistrohen si të papunë pranë zyrës së punës, të paraqesin kërkesën me shkrim dhe të plotësojnë dokumentacionin përkatës brenda 60 ditëve nga data e lindjes të së drejtës për të përfutur këto të ardhura. Në të kundërt ata e humbasin këtë të drejtë. Përfuturim bëjnë rastet kur personat e papunë janë të sëmurë dhe e vërtetojnë vonesën e kërkesës me raport mjeko-ligjor.

2. Personat, një herë në muaj, në datën e caktuar ose sa herë thirren, të paraqiten në zyrën e punës. Në rast mosparaqitjeje pa shkaqe objektive humbasin të drejtën e përfitimit të këtyre të ardhurave.

3. Kur personi që përfiton të ardhura nga papunësia punësohet ose vetëpunësohet, është i detyruar të lajmërojë zyrën e punës brenda 5 ditëve. Në të kundërt paguan shumën e të ardhurave nga papunësia, që e ka përfutur në mënyrë të padrejtë.

4. Çdo person, gjatë periudhës që merr të ardhura nga papunësia, detyrohet të njoftojë zyrën e punës për ndryshimet në gjendjen familjare, nëse personat në ngarkim të tij mbushin moshën 15 vjeç ose ndryshojnë kushtet e tjera të përfitimit të të ardhurave nga papunësia.

VIII. PAGESA E PËRFITIMEVE

Pensionet e ish –anëtarëve të kooperativave bujqësore, të ardhurat që përfitojnë personat e siguruar për lejen e periudhës së shtatzanisë dhe të paslindjes, shpërblimet për lindjen e fëmijëve dhe pagesat për vdekje, paguhen nga zyrat e financës së komunave, për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore.

Datat e pagesave të pensioneve caktohen nga këshilli i komunës. Zyra e financës së komunës përgjigjet për shpërndarjen e rregullt të pensioneve.

Drejtoritë e sigurimeve shoqërore i dërgojnë zyrtarisht zyrës së financës së komunës urdhër-pagesat tip për pagesën e pensioneve. Urdhër-pagesat duhet të jenë të plotësuara qartë, saktësisht dhe pa korrigjime. Urdhër-pagesa është akt autorizues, ndërsa pagesa e shumës së pensionit dokumentohet me anë të listë - pagesës.

Në datën e caktuar, drejtoritë e sigurimeve shoqërore pajisin personin e autorizuar nga kryetari i komunës me një çek-pagesë për tërheqjen e mjeteve monetare për pagesën e pensioneve.

Për shërbimin e pagesës së pensioneve, drejtoritë e sigurimeve shoqërore i paguajnë komunës një komision në masën 0.5 për qind të shumës së paguar.

Marrëdhëniet administrative e financiare ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Ministrisë së Punës e Çështjeve Sociale, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, bankave, Albapost sh.a. dhe Ministrisë së Pushtetit vendor të rregullohen me akte nënligjore të përbashkëta.

Ngarkohen Ministria Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor të nxjerrin udhëzime në zbatim të këtij vendimi.

Vendimi nr.112, datë 18.3.1999 i Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.384, datë 14.7.2000 të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimi nr. 1, datë 18.3.1999 i Këshillit të Ministrave, ndryshuar në udhëzimin nr. 3, datë 14.7.2000 të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.403,datë 11.6.2001

PËR RITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror” dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve, të caktuara sipas ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996 rriten në masën 8 për qind, duke filluar nga data 1.7.2001, përfshirë dhe këtë datë.

2. Pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, rriten në masën 8 për qind, duke filluar nga data 1.7.2001, përfshirë dhe këtë datë.

3. Efektet financiare për rritjen e përfitimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi janë parashikuar në buxhetin e vitit 2001 për sigurimin suplementar të ushtarakëve dhe llogaritjen në shumën:

35.483.000 (tridjetë e pesë milionë e katërqind e tëdhjetë e tre mijë) lekë për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakëve;

576.000 (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, për pensionet familjare, të familjeve në ngarkim të pilotëve që kanë humbur jetën gjatë fluturimit në përmbushje të detyrës.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Banka e Kursimeve dhe Albapost, sh.a. për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.404,datë 11.6.2001

PËR RITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet e invaliditetit, pensionet

familjare, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 8 për qind.

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit, pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pensionet e caktuara sipas pikës 4 të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 me ndryshimet përkatëse, rriten në masën 30 për qind.

3. Këtë rritje në masat e mësipërme, e përfitojnë dhe pensionet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, që do të caktohen pas datës 1.7.2001, kur data e fillimit të pensionit është përpara datës 30.6.2001, duke përfshirë dhe këtë datë.

4. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, të caktuara me datë fillimi nga data 1.7.2001 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 5560 (pesë mijë e pesë qind e gjashtë dhjetë) lekë në muaj dhe jo më shumë se 11.120 (njëmbëdhjetë mijë e njëqindnjëzet) lekë në muaj për pensionet e caktuara sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, si dhe jo më pak se 1726 (një mijë shtatëqind e njëzet e gjashtë) lekë në muaj e në vazhdim për pensionet e caktuara sipas pikës 4 të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

5. Shtesa mujore, e përfituar nga vendimi nr.326, datë 21.6.1993 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar” rritet në masën 8 për qind.

6. Pensionet e posaçme dhe shtesat e pensioneve shtetërore, të caktuara sipas nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” rriten në masën 8 për qind.

7. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut” rriten në masën 8 për qind.

8. Efektet financiare për vitin 2001, nga rritja e pensioneve arrijnë shumën 1 370 000 000 (një miliardë e treqind e shtatëdhjetë e tetë milionë) lekë. Kjo shumë të përballohet nga:

a) fondet e sigurimeve shoqërore të programuara në buxhetin e vitit 2001: 1 080 000 (një milion e tetëdhjetë mijë) lekë.

b) teprica e fondit të sigurimeve shoqërore për vitin 2000: 290 000 000 (dyqind e nëntëdhjetë milionë) lekë.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Banka e Kursimeve dhe Albapost sh.a. për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

10. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për përballimin e vëllimit të punës për rritjen e pensioneve, t’i shtohen në fondin e pagës 3 000 000 (tre milionë) lekë, të cilat të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001, zëri “Shpenzime administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M **Nr.410,datë 11.6.2001**

PËR NGRITJEN E QENDRËS KOMBËTARE SHKENCORE TË HIDROKARBUREVE (QKSHH) DHE PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të neneve 13 dhe 23 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, ndryshuar me ligjin nr.8401, datë 9.9.1998, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve me seli në Fier, në përbërje të

së cilës përfshihen Instituti i Naftës dhe Gazit, Fier dhe Qendra e Përpunimit të Informacionit Gjeofizik, Fier.

2. Miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Pika 3 e vendimit nr.756, datë 26.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për ristrukturimin e “Albpetrol” sh.a shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

STATUTI

I QENDRËS KOMBËTARE SHKENCORE TË HIDROKARBUREVE (QKSHH)

KREU I

DISPOZITA KRYESORE

Neni 1

Krijimi dhe emërtimi

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve (QKSHH) ngrihet në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”.

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve është trashëgimtarja ligjore e institucioneve dhe e njësisë shkencore të përfshira në të.

Ky statut përcakton objektin, veprimtarinë, pronësinë, të drejtat, detyrat, organizim-funksionimin dhe burimet financiare të Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve.

Neni 2

Selia

Selia e QKSHH-së është në qytetin e Fierit.

Neni 3

Forma

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve është institucion shkencor, në formën e personit juridik publik dhe administrativisht varet nga ministria që mbulon sektorin e hidrokarbureve.

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve është institucion këshillimor shkencor i shtetit shqiptar për të gjitha problemet shkencore në fushën e hidrokarbureve, kryen studime, oponenca, konsulenca dhe asistencë teknike në interes të institucioneve dhe të organeve qendrore të shtetit, si dhe të të tretëve kundrejt marrëdhënieve kontraktore.

Neni 4

Qëllimi

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve realizon detyra shkencore në zhvillimin e shkencës të gjeologjisë, të gjeofizikës, të teknologjisë së nxjerrjes së naftës, të shpimit të puseve, të inxhinierisë së rezervuarit dhe shkencave të përfaqësuara me to.

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve i shërben zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, kualifikimit të pandërprerë të personelit të tij dhe formimit të shkencëtarëve të rinj.

Ajo zgjidh dhe detyra të veçanta që i dalin vendit në fushën e gjeoshkencave.

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve realizon veprimtarinë shkencore mbështetur në materialin faktik dhe studimet gjeologjike, gjeofizike e teknologjike për hidrokarburet, si dhe kryen punë studimore me të gjitha kompanitë e naftës e të gazit në vend.

Neni 5
Prona e shtetit në administrim

Fondi i materialeve faktike gjeologjike, gjeofizike e teknologjike, të përfituara në fushën e hidrokarbureve që janë pronë e shtetit (të dhënat primare ekzistuese dhe që do të krijohen), i lihen në administrim QKSHH-së si i vetmi institucion kompetent në këtë fushë, përveçse në rastet kur kuadri ligjor në fuqi përcakton ndryshe.

Arkivi dhe fondi i studimeve gjeologjike, gjeofizike e teknologjike, të realizuara prej QKSHH-së kudo që ndodhen, janë pronë e shtetit dhe administrohen nga institucioni.

Marrëdhëniet me të tretët për përdorimin e këtyre fondeve rregullohen me akte nënligjore.

QKSHH-ja gëzon në administrim dhe përdorim kapitalin fizik (godina, troje sipas regjistrimit në institucionet përkatëse), si dhe të gjitha mjetet themelore (aparatura, pajisje, automjete, orendi pune etj.), sipas inventarit fizik të pronësisë shtetërore.

KREU II
VEPRIMTARIA SHKENCORE E QKSHH-SË

Neni 6
Drejtimit e veprimtarisë shkencore

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve kryen:

- veprimtari shkencore e zhvillimit teknologjik;
- veprimtari shërbimi shkencor e teknologjik;
- veprimtari transformimi të teknologjisë;
- veprimtari informacioni shkencor e teknik;
- veprimtari kualifikimi e specializimi;

Neni 7
Objekti i veprimtarisë shkencore

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve kryen veprimtari shkencore e zhvillim teknologjik, duke realizuar:

- studime fundamentale në fushat e gjeologjisë, gjeofizikës dhe teknologjisë së nxjerrjes së naftës dhe shpimit të puseve;
 - studime gjeologjike bazë nëpërmjet hartografimit (rivelime) në shkallë të ndryshme;
 - studime për zhvillimin e vendburimeve ekzistuese të naftës e gazit dhe të atyre që do të zbulohen;
 - studime statigrafike, të paraprirë prej studimeve analitike e faktike të paleontologjisë, petrografisë, mineralogjisë etj;
 - studime sedimentologjike, tektonike, statigrafike sekuenciale etj;
 - studime gjeokimike e hidrogeologjike për vlerësimin e potencialit hidrokarburmbajtës në një basen të caktuar;
 - studime të konstruksionit të shpimit të puseve e të lëngjeve larës;
 - studime gjeofizike për hidrokarbure të paraprirë nga ato sizmike, (përpunimi dhe interpretimi i informacionit sizmik), gravimetrike, elektro-fizike të shkëmbinjve e të lëngjeve nëpërmjet gjeofizikës kanteriale (përpunimi dhe interpretimi);
 - studime për mjedis, ndotje, gjeologji inxhinierike, kariera sipërfaqësore deri në ato të shelfit kontinental (batimetri ujore, situacion, palzh, porte, delta, tokë buke, etj);
 - studime për projekte mekanike, sipërfaqësore të industrisë së naftës e gazit;
 - studime mbi infrastrukturës e grumbullimit, ruajtjes, transportimit të naftës e gazit në rezervuaret mbi dhe nëntokësore, si dhe stokimin e gazit në rezervuaret natyrore.
- Ajo kryen vetë ose në bashkëpunim veprimtari për hidrokarbure në gjithë territorin e Shqipërisë (tokë-det) dhe jashtë tij:
- studime të perspektivës afatgjatë e afatmesëm;

- studime në kërkim-zbulimin e objekteve të rinj për naftë dhe gaz;
- studime mbi kapacitetin naftëmbajtës dhe zhvillimin e vendburimeve ekzistuese;
- studime për përpunimin dhe përmirësimin teknologjik të vendburimeve të naftës dhe gazit;
- studime që lidhen me fushat e afërta me to.

Merr përsipër të realizojë nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale aktivitetin shkencor të shoqërive të naftës dhe të gazit.

Kryen studime, oponenca, konsulenca dhe asistencë teknike për organizmat shtetërore në zonat ku kryejnë aktivitetet konkret për hidrokarbure kompanitë e huaja për kërkimin dhe zhvillimin e vendburimeve të naftës e të gazit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse të lidhura me këto kompani.

Kryen studime në fushën e gjeoshkencave (hidrokarbure) dhe teknologjive përkatëse, të cilat kanë interesa kombëtare dhe/ose ndërkombëtare të akorduara nga institucionet shtetërore.

Kryen studime të karakterit akademik, teorik e pedagogjik, që lidhen me zhvillimin e prezantimin e konceptimeve të reja në fushën e hidrokarbureve.

Kryhen studime të përbashkëta me organizma dhe institucione të huaja shkenxore, që janë në funksion të interesave të shtetit dhe të partnerëve të huaj (në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare ose të projekteve të përbashkëta).

Përpunon sipas teknikave e standardeve shkencore ndërkombëtare, të dhënat gjeologjike, gjeofizike, teknologjike dhe ekonomiko-administrative, që lidhen me veprimtarinë e kërkim-shfrytëzimit të hidrokarbureve në Shqipëri, duke shprehur interesat e shtetit në këtë sektor.

Përgatit materiale të nevojshme (paketa me të dhëna, studime etj.) për qëllime tregtare, sipas kërkesave të ministrisë që mbulon sektorin hidrokarbur.

Kryhen studime në interes të shtetit në fushën e mjedisit, hidrogeologjisë hidrokarbure, si dhe për efekte teoriko-praktike të gjeologjisë aktuale.

Organizon dhe prezanton në simpoziume kombëtare e ndërkombëtare arritjet shkencore të studimeve në fushat e gjeoshkencave për kërkim-zhvillim të hidrokarbureve.

Publikon artikuj, revista, manuale, monografi, bibliografi, albume, atlase etj. në entet botuese publikuese brenda e jashtë Shqipërisë.

Kryhen studime shkencore analitike dhe analiza në kuadrin e standardeve shtetërore, si dhe angazhime të veçanta në interes të të tretëve.

Realizon kualifikime me karakter teoriko-praktik për inxhinierët dhe teknikët e sektorit hidrokarbur, si dhe angazhohet në prezantimin e arritjeve në qendrat universitare brenda e jashtë vendit.

Ka të drejtë të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi shkencor dhe tregtar, sipas fushave të veprimtarisë së saj me persona fizikë e juridikë vendas e të huaj, sipas ligjeve në fuqi.

KREU III

TË DREJTAT MBI AUTORËSINË DHE ADMINISTRIMIN E PRONËS

Neni 8

E drejta e autorit

QKSHH-ja gëzon të drejtën e autorit të të gjitha studimeve, projekteve dhe publikimeve të kryera në të gjitha fushat e veprimtarisë së këtij institucioni, të cilat janë realizuar ose do të realizohen prej njërive shkencore përbërëse të saj.

Ka të drejtën e autorësisë mbi fondet e materialeve faktike (të dhënat primare) gjeologjike, gjeofizike, teknologjike etj., të përfuara në fushën e naftës e gazit, që janë realizuar ose do të realizohen prej njërive shkencore përbërëse të saj.

Neni 9

Përdorimi

QKSHH-ja ka të drejtën për të administruar, njohur dhe përdorur studimet që janë kryer dhe do të kryhen në fushën e hidrokarbureve prej personave juridikë në territorin shqiptar, të cilat janë depozituar sipas marrëveshjeve përkatëse në institucione shtetërore, në përputhje me kushtet e këtyre

marrëveshjeve.

Neni 10

Mbrojtja e të drejtës së autorit

QKSHH-ja ka të drejtë të mbrojë të drejtën e autorit të sajën dhe të drejtat e autorësisë të specialistëve të saj.

Riprodhimi dhe publikimi i studimeve dhe i çdo materiali tjetër dokumentar e shkencor të QKSH-së kryhet vetëm me lejen me shkrim të Drejtorisë Ekzekutive të kësaj qendre.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE ORGANET DREJTUESE

Neni 11

Organet drejtuese

Qendra Kombëtare Shkencore e Hidrokarbureve përbëhet nga njësi me aktivitet shkencor të pavarur.

Organet drejtuese të QKSHH-së janë Këshilli Drejtues dhe Drejtoria Ekzekutive.

Veprimtaria e Këshillit Drejtues dhe e Drejtorisë Ekzekutive të QKSHH-së mbështetet në këtë statut dhe rregulloren e brendshme të këtij institucioni që miratohet nga ministri.

Neni 12

Këshilli Drejtues

Anëtarët e Këshillit Drejtues përzgjidhen ndër punonjësit shkencorë me autoritet dhe emërohen nga ministri.

Këshilli Drejtues i QKSHH-së përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë ku përfshihet Drejtori, 1(një) autoritet shkencor me përvojë në shkencat hidrokarbure, 1 (një) i Akademisë së Shkencave, 1(një) i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, 2(dy) nga struktura të ministrisë që mbulon sektorin e hidrokarbureve dhe 1 (një) nga shoqëritë anonime vendase që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve.

Kohëzgjatja e të emëruarve në Këshillin Drejtues është 3 vjet me të drejtën e një riemërimi.

Këshilli Drejtues zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin, të cilët drejojnë veprimtarinë e këtij Këshilli.

Këshilli Drejtues mund të caktojë një person si sekretar edhe jashtë radhëve të tij.

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet me miratim të ministrit.

Neni 13

Drejtori

Drejtori i QKSHH-së dhe zëvendësit e tij propozohen nga Këshilli Drejtues dhe emërohen nga ministri nga kandidatura alternative me autoritet dhe grada shkencore.

Neni 14

Kompetencat e Këshillit Drejtues

- a) Këshilli Drejtues i QKSHH-së shqyrton dhe i propozon për miratim ministrit:
 - programin vjetor të zhvillimit shkencor dhe ekonomiko-financiar të QKSHH-së;
 - rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionit të QKSH-së;
 - strukturën organizative të pagave dhe organikën e QKSHH-së;
 - kriteret bazë të marrjes, mbajtjes dhe trajtimit të punonjësve shkencorë dhe personelit ndihmës, kriteret e shpërndarjes së pagave dhe shpërblimet e punonjësve;
 - çmimet e shitjes së punimeve dhe studimeve shkencore.
- b. Këshilli Drejtues kontrollon zbatimin e programit vjetor të zhvillimit shkencor dhe

ekonomik të QKSHH-së.

Neni 15

Mbledhjet e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues i QKSHH-së mbledhet dhe shqyrton materiale në bazë të planit vjetor të punës.

Këshilli Drejtues mbledhet sa herë që e kërkon interesi i QKSHH-së, por jo më pak se një herë në tre muaj.

Këshilli Drejtues i QKSHH-së thirret nga Kryetari ose me kërkesën e tre anëtarëve të Këshillit. Mbledhja e Këshillit Drejtues të QKSHH-së thirret edhe me kërkesën e motivuar të Drejtorit të QKSHH-së.

Ministri ka të drejtë të thërrasë Këshillin Drejtues të QKSHH-së sa herë që ai e gjykon të arsyeshme.

Neni 16

Drejtoria Ekzekutive

Drejtori, zëvendësit dhe shefat e departamenteve përbëjnë Drejtorinë Ekzekutive dhe përgjigjen për gjithë aktivitetin e QKSHH-së.

Drejtori:

- përfaqëson QKSHH-në në të gjitha marrëdhëniet juridike;
- kryeson, thërret dhe drejton mbledhjet e Drejtorisë Ekzekutive;
- përgjigjet për zbatimin e vendimeve të Drejtorisë Ekzekutive.

Këto detyra mund t'i realizojë edhe zëvendësi me auorizim të drejtorit.

Drejtoria Ekzekutive:

- bën emërimin e punonjësve bazë të rezultateve të konkursit për plotësimin e strukturës.
- jep urdhëra, udhëzime dhe vendos sanksione, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- raporton, nëpërmjet drejtorit përpara Këshillit Drejtues për ecurinë e programit të zhvillimit ekonomik dhe shkencor të QKSHH-së.

- raporton në ministri në fund të vitit kalendarik dhe sa herë që e kërkojnë strukturat ekzekutive, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Detyra të specifikuar përcaktohen në rregulloren e brendshme të QKSHH-së.

Neni 17

Personeli

Personeli i QKSHH-së përbëhet nga personeli shkencor dhe personeli administrativ.

Personeli shkencor i QKSHH-së është i lirë në zgjedhjen e metodave të kërkimit dhe të zhvillimit, në qoftë se në dokumentet përkatëse të miratuara në bazë të të cilave ai punon (programe, projekte, kontrata, detyra) nuk është thënë ndryshe.

Personeli shkencor i QKSHH-së nuk lejohet të kryejë detyra ose veprimtari shkencore (në mënyrë private), njëkohësisht, edhe për kompani ose institucione simotra që konkurojnë dhe që janë në konflikt interesash me QKSHH-në, përveçse kur në aktet ligjore ose nënligjore përcaktohet ndryshe dhe në këtë rast merret leja nga Drejtoria Ekzekutive, duke hartur një kontratë dypalëshe.

Neni 18

Këshilli shkencor

Këshilli Drejtues i QKSHH-së dhe drejtori, për tematikën dhe problemet shkencore, ndihmohen nga Këshilli Shkencor i QKSHH-së, këshillat teknikë të departamenteve dhe aparati administrativ.

Këshilli Shkencor i QKSHH-së përbëhet nga 9-13 (me përbërje numër tek) anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm.

Numri i anëtarëve të jashtëm nuk duhet të kalojë një të tretat e numrit të përgjithshëm të

anëtarëve të Këshillit Shkencor.

Anëtarët e Këshillit Shkencor propozohen prej Drejtorisë Ekzekutive nga rradhët e punonjësve shkencorë me autoritet, duke marrë edhe mendimin e Këshillit Drejtues të QKSHH-së.

Miratimi i anëtarëve të Këshillit Shkencor bëhet nga ministri.

Këshilli Shkencor i QKSHH përbën organin shkencor kryesor që shqyrton dhe miraton punimet e studimit shkencor, tërësore të realizuara nga institucioni, si dhe shqyrton dhe jep mendim për programet dhe strategjinë e zhvillimit të QKSHH.

Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Shkencor, bëhet sipas rregullores përkatëse, që miratohet nga Këshillit Drejtues i QKSHH.

KREU V AKTIVITETI FINANCIAR

Neni 19 **Burimet financiare**

Aktiviteti financiar i QKSHH-së zhvillohet në kuadër të ministrisë së vartësisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar për institucionet shkencore.

QKSHH-ja siguron burime financiare:

1. nga shteti kundrejt projekteve që ministria ose institucione dhe organe të tjera shtetërore kërkojnë për të realizuar; Ministria kontrollon realizimin e këtij financimi sipas projekteve;

2. nga APC, sh.a. për problematikën dhe programet imediate ose në perspektivë që zgjidh në kuadër të shoqërive të naftës të gazit (Albpetrol, sh.a. ARMO, sh.a. SERVOCOM, sh.a), sipas projekteve;

3. nga të tretët:

- a) aktiviteti shkencor e teknologjik (studim, projekt, analiza) në shërbim të të tretëve (firma e persona juridikë, privatë, shtetërore e të huaj);
- b) bashkëpunimi tekniko-shkencor ndërkombëtar;
- c) fondacione e donatorë të ndryshëm;
- d) patentat dhe shpikjet;
- e) veprimtaria e njësisë prodhuese të institucionit;
- f) porositë e të tretëve, si dhe publikimet, kurse kualifikimi etj;
- g) aktivitete të tjera.

Neni 20 **Përdorimi i të ardhurave nga të tretët**

Të ardhurat që QKSHH-ja siguron nga veprimtaria me të tretët i nënshtrohen procedurave fiskale të shtetit dhe pjesa tjetër përdoret me miratimin e ministrit përgjegjës për hidrokarburet, për fuqizimin me pajisje e mjete teknologjike, për kualifikimin e specializimin e personelit, shpërblime etj.

Neni 21 **Pagat**

Struktura dhe niveli i pagave të punonjësve të QKSHH-së propozohet nga Këshilli Drejtues dhe miratohet nga ministri

Pagat mbulohen nga të ardhurat e QKSHH-së.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Ky Statut hyn në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave dhe mund të

ndryshohet në çdo kohë po me vendim të Këshillit të Ministrave.

U D H Ë Z I M
Nr. 5, datë 31.5.2001

**PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE, TË VLERAVE TË TREGUT TË LIRË TË BANESAVE DHE TË
KOEICIENTIT “K”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 13 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2001 të jetë 30 867 (tridhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi, sipas tabelës “Kosto mesatare për vitin 2000”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

2. Vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave në shkallë qarku për vitin 2001 të jetë sipas tabelës “Të dhëna për tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2001”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi”.

3. Vlera e koeficientit “k”, në zbatim të nenit 3 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” të jetë sipas tabelës përkatëse, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

KOSTO MESATARE PER VITIN 2000

NR	EMERTIMI I BANESES	ÇMIMI PER NJESI		% INVEST. kundrejt	PJESE E ÇMIMIT SIPAS %	
		Sip.Ndert	Sip.Shfrytz.		Sip.Ndert	Sip.Shfrytz.
		LEK/M2	LEK/M2	TOTALIT	LEK/M2	LEK/M2
1	2	3	4	5	6	7
1	BERAT	23.720	29.312	2,94	698	863
2	DIBER	21.804	31.054	2,06	449	639
3	DURRES	23.710	27.810	7,83	1.857	2.178
4	ELBASAN	20.684	26.399	8,55	1.768	2.257
5	FIER	22.737	29.601	4,14	941	1.226
6	GJIROKASTER	23.420	28.926	1,33	312	385
7	GRAMSH	22.116	28.258	0,44	97	124
8	KAVAJE	22.001	27.173	5,47	1.203	1.486
9	KORÇE	21.641	26.729	4,56	987	1.218
10	KRUJE	23.798	30.407	1,33	317	405
11	KUÇOVE	25.007	30.902	1,15	288	356
12	KUKES	23.977	29.963	1,46	351	438
13	LAÇ	23.795	29.404	2,73	649	802
14	LEZHE	21.432	27.952	2,19	469	611
15	LIBRAZHD	20.688	26.403	0,75	155	198
16	LUSHNJE	23.622	30.181	2,49	589	753
17	MIRDITE	24.068	29.218	0,73	177	215
18	MAT	23.772	28.859	2,89	687	834
19	PEQIN	20.736	26.465	0,28	58	74
20	PERMET	22.499	27.789	0,88	197	243
21	POGRADEC	24.933	31.083	1,26	315	392
22	PUKE	33.010	40.722	0,72	238	293
23	SARANDE	25.626	31.667	1,04	268	331
24	SHKODER	27.073	33.617	11,15	3.019	3.748
25	SKRAPAR	19.203	24.536	2,36	452	578
26	TEPELENE	23.637	28.695	2,29	542	658
27	TROPOJE	34.333	42.354	1,21	415	512
28	VLORE	36.418	44.907	5,35	1.949	2.404
29	TIRANE	28.641	32.567	20,41	5.845	6.646
	KOSTO MESATARE				25291	30867

TË DHËNAT PËR TREGUN E LIRË TË APARTAMENTEVE PËR VITIN 2001

Nr	QYTETET	Lek/m ² sipërfaqe shfrytëzimi
1	Berat	33454
2	Bulqizë	12916
3	Cërrik	33273
4	Delvinë	18477
5	Devoll	29364
6	Dibër	23017
7	Durrës	62770
8	Elbasan	47577
9	Fier	47073
10	Fushë - Arrez	13736
11	Gjirokastrë	34348
12	Gramsh	38838
13	Has	29923
14	Kavajë	46430
15	Kolonjë	19258
16	Korçë	27684
17	Krujë	31070
18	Kuçovë	27010
19	Kukës	27505
20	Laç	35196
21	Leskovik	11936
22	Lezhë	51471
23	Librazhd	45974
24	Lushnjë	39088
25	M. Madhe	18199
26	Maliq	13633
27	Mallakstrë	34821
28	Mat	16894
29	Memaliaj	8911
30	Mirditë	30690
31	Patos	27544
32	Peqin	41049
33	Përmet	27991
34	Pogradec	35471
35	Pukë	13736
36	Roskovec	25689
37	Rubik	24576
38	Sarandë	42338
39	Shkodër	38087
40	Skrapar	15297
41	Tepelenë	13947
42	Tiranë	56306
43	Tropojë	12710
44	Vau - Dejes	20154
45	Vlorë	48317
46	Mamurras	17552

**VLEFTA E KOEFICIENTIT "K" SIPAS LIGJIT Nr. 8030 Dt. 15.11.1995
"PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA"**

Nr	QYTETET	Vlefte e Koeficientit "K"
1	Berat	1,000
2	Bulqizë	0.416
3	Cërrik	1,000
4	Delvinë	0.584
5	Devoll	1,000
6	Dibër	0.741
7	Durrës	1,000
8	Elbasan	1,000
9	Fier	1,000
10	Fushë - Arrez	0.337
11	Gjirokastër	1,000
12	Gramsh	1,000
13	Has	1,000
14	Kavajë	1,000
15	Kolonjë	0.72
16	Korçë	1,000
17	Krujë	1,000
18	Kuçovë	0.874
19	Kukës	0.918
20	Laç	1,000
21	Leskovik	0.447
22	Lezhë	1,000
23	Librazhd	1,000
24	Lushnjë	1,000
25	M. Madhe	0.541
26	Maliq	0.510
27	Mallakstër	1,000
28	Mat	0.585
29	Memaliaj	0.310
30	Mirditë	1,000
31	Patos	0.930
32	Peqin	1,000
33	Përmet	1,000
34	Pogradec	1,000
35	Pukë	0.337
36	Roskovec	0.867
37	Rubik	0.841
38	Sarandë	1,000
39	Shkodër	1,000
40	Skrapar	0.623
41	Tepelenë	0.486
42	Tiranë	1,000
43	Tropojë	0.300
44	Vau - Dejes	0.600
45	Vlorë	1,000
46	Mamurras	0.597

U D H Ë Z I M
Nr.50, datë 15.6.2001

**PËR TË DREJTAT DHE DETYRAT E SEKRETARIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS
SË VOTIMIT**

Në mbështetje të nenit 153 të Kushtetutës dhe të neneve 43, 44, 46 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Për zbatimin e ligjit, gjatë procesit parazgjedhor dhe zgjedhor, si dhe për njësimin e praktikave zgjedhore, lidhur me kriteret e zgjedhjes, të drejtat dhe detyrat e sekretarit të komisionit të qendrës së votimit, të veprohet si vijon:

1. Sekretari i KQV emërohet sipas parashikimit të bërë në nenin 43 të Kodit Zgjedhor, vetëm për periudhën e zgjedhjeve.

a) Sekretar i KQV-së zgjidhet shtetasi shqiptar me vendbanim në Shqipëri i cili nuk duhet të ketë asnjë prej pengesave të parashikuara në nenin 43 pika 4, 5, 6 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

A. Të drejtat e sekretarit të komisionit të qendrës së votimit:

1. Merr pjesë si anëtar pa të drejtë vote në të gjitha mbledhjet e KQV-së.

2. Diskuton dhe jep mendimin e tij në mbledhjet e KQV-së, për çështje që shqyrtohen sa herë që e shikon të arsyeshme apo kur një gjë e tillë kërkohet nga anëtarët e komisionit.

3. Evidenton dhe parashtron para KQV-së problemet që kërkojnë zgjidhje, në zbatim të ligjit, akteve dhe urdhërimeve të tjera të KQZ-së dhe KZZ-së.

4. Të drejta të tjera të parashikuara nga ligji dhe akte të nxjerra nga KQZ.

B. Detyrat e sekretarit të komisionit të qendrës së votimit

Nën drejtimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KQV-së, sekretari i komisionit të qendrës së votimit kryen këto detyra:

1. Vendosi dhe mban kontakte me të gjithë anëtarët e KQV-së.

2. Kujdeset për njoftimin e anëtarëve të KQV-së lidhur me kohën, vendin dhe çështjet që shqyrtohen në mbledhjet e KQV-së, si dhe për veprimtari të tjera që realizohen prej këtij komisioni.

3. Mban procesverbalin e diskutimeve në mbledhjet e KQV-së dhe kujdeset për respektimin e rregullave dhe normave në fuqi, për mënyrën e zhvillimit të mbledhjes, diskutimeve dhe vendimmarrjes në to.

4. Kujdeset dhe përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e bazës materiale në përgjithësi dhe të materialeve të votimit në veçanti.

5. Merr në dorëzim së bashku me kryetarin edhe zëvendëskryetarin e KQV-së, materialet e zgjedhjeve të shpërndara nga KZZ-ja ose sipas rastit, nga KZQV-ja.

6. Mban procesverbalin të marrjes në dorëzim të materialeve të votimeve, i cili depozitohet dhe në procesverbalin e qendrës së votimit.

7. Kujdeset dhe përgjigjet për ruajtjen dhe përdorimin e vulës së KQV-së. Ai vulos gjithë aktet e KQV-se, që merren me shumicë votash, si dhe korrespondencën e KQV-së me KZZ-në.

8. Kujdeset dhe ndjek ecurinë e procesit zgjedhor në veçanti lidhur me çështjet vijuese:

a) Komunikimi me KZZ-në për çështje që lidhen me zbatimin e ligjit, të akteve të KQZ-së dhe KZZ-së si dhe të urdhërimeve të tjera të tyre përkatësisht për KZZ-të dhe KQV-të.

b) Komunikimi me institucionet shtetërore, subjektet zgjedhore e politike dhe vëzhguesit e akredituar, vendas e të huaj, evidentimi dhe paraqitja në KQV e komenteve për çdo parregullsi që pretendohet prej tyre.

c) Shënon në procesverbalin e qendrës së votimit kohën e largimit dhe të kthimit të çdo anëtar i që largohet prej qendrës së votimit (neni 95/2).

9. Organizon punën për mbylljen e kutive të votimit dhe merr masat për dorëzimin brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit të kutive të votimit dhe zarfin me procesverbalet e votimit, sipas

mënyrave të parashikuara nga KZZ (neni 106/10).

10. Kryhen detyra të tjera të parashikuara nga ligji dhe akte të nxjerra nga KQZ dhe KZZ.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr. 51, date 18.6.2001

PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË BOJËS SË MATRIKULLIMIT
GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

Në mbështetje të nenit 18, 97 e 153 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

U D H Ë Z O N :

Për mënyrën e përdorimit të bojës së matrikullimit gjatë procesit zgjedhor në qendrat e votimit të veprohet si vijon:

- Çdo qendër votimi të ketë bojën e matrikullimit dhe një shkop plastik me pambuk për shënjim.

- Çdo zgjedhës, i cili hyn në qendrën e votimit për të ushtruar të drejtën e votës, është i detyruar t'i nënshtrohet procedurës së matrikullimit.

- Një anëtar i komisionit të qendrës së votimit kontrollon nëse zgjedhësi është ose jo i matrikulluar më parë. Nëse zgjedhësi nuk ka asnjë shenjë në gisht, atëherë anëtar i KQV-së matrikullon me bojë, nëpërmjet një shkopi plastik me pambuk, gishtin e madh të dorës së majtë në pjesën fundore të thoit. Kur matrikullimi nuk mund të bëhet në këtë dorë, si pasojë e dëmtimeve fizike të gishtit, vendosja e shenjës bëhet në gishtin e madh të dorës së djathtë.

- Më pas zgjedhësi vazhdon me procedurat e tjera votimit, për të ushtruar të drejtën e votës.

- Kur zgjedhësi që paraqitet për të votuar konstatohet se ka shenjë e bojës së matrikullimit në gisht, atëherë komisioni mban shënim të dhënat personale dhe identitetin e zgjedhësit dhe vendos për ndërprerjen e procedurave të mëtejshme të votimit për këtë zgjedhës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi

U D H Ë Z I M
Nr. 52, datë 18.6.2001

PËR NGRITJEN E QENDRAVE TË VOTIMIT NË INSTITUCIONE TË POSAÇME

Në mbështetje të neneve 18, 47, 59 dhe 93 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

U D H Ë Z O N :

1. KZZ-ja që ka brenda territorit të zonës së saj institucione të posaçme (spitale, burgje, vende paraburgimi) krijon në këto institucione qendër votimi të veçantë, kur në to ditën e votimit janë të paktën 15 zgjedhës.

2. Drejtuesi i institucionit, kur konstaton se në institucionin që drejton ka mbi 15 votues, tre ditë përpara datës së zgjedhjeve, brenda orës 18.00, dorëzon në KZZ-në përkatëse listën e votuesve (

sipas modelit bashkëlidhur), të nënshkruar dhe vulosur në çdo faqe.

3.Me sigurimin e këtyre listave, KZZ-ja merr vendim për ngritjen:

a) qendrës së votimit,

b) komisionit të qendrës së votimit, me të njëjtën formulë dhe në të njëjtën mënyrë, si dhe për qendrat e tjera të votimit.

4. Drejtuesi i institucionit i siguron komisionit të qendres së votimit, mjediset e përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin normal të qendrës së votimit, të paktën 24 orë përpara datës së zgjedhjeve, ora 18.00.

5. KZZ-ja dhe komisioni i qendrës së votimit, kryejnë të gjitha procedurat për përgatitjen e qendrës së votimit dhe realizimin e procesit të votimit, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e KQZ-së dhe manualit të qendrës së votimit, njëlloj si gjithë qendrat e tjera të votimit të KZZ-së.

6. Nëse në një institucion ka më pak se 15 zgjedhës, nuk krijohet qendër votimi dhe drejtuesi i institucionit duhet të marrë gjithë masat e mundshme për t'u krijuar kushte votuesve për të ushtruar të drejtën e votës në vendbanimin (ose vendqëndrimin) e votuesit për rastin e spitaleve ose përfshirjen e tyre në listën e votuesve të një institucioni të ngjajshëm për rastin e të burgosurve ose të paraburgosurve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari

Gaspër Kokaj

Ministria e _____

Drejtoria e _____

Lista e votuesve të institucionit të posacëm _____

Nr.	Emri atësia mbiemri	Datëlindja	Firma
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			

D R E J T O R I

Vula(_____)

_____ më, 21.6.2001

V E N D I M

Nr. 47, datë 2.6.2001

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISION VENDOR PRIVAT “MIRDITA TV”

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, Z. KASTRIOT RECI licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr. 48, datë 2.6.2001

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT "TOP CHANNEL"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "TOP CHANNEL" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Sefedin Çela

AUTORIZIM ZYRTAR
Nr. 5, datë 13.4.2001

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI

Në mbështetje të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe /ose risigurimit" të ligjit nr.8606, datë 27.4.2000 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe /ose risigurimit, ndryshuar në ligjin nr.8458, datë 11.02.1999", si dhe të akteve të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit.

KOMISIONI I MBIKQYRJES SË SIGURIMEVE
AUTORIZON:

Shoqërinë Anonime "ATLANTIK" sh.a. me seli në Tiranë, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me nr. Akti 25720, të kryejë sigurime për dëmet, në përputhje me lejen për ushtrim aktiviteti.

LEJE

PËR Fillimin e ushtrimit të aktivitetit të sigurimeve dhe/ose risigurimeve

Shoqëria e sigurimit “ATLANTIK” sh.a., e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me nr. Akti 25720, me seli në Tiranë në adresën :”DORO CENTER, Rruga Muhamet Gjolllesha”, lejohet të fillojë kryerjen e operacioneve të sigurimit në grupet e sigurimit, siç janë listuar më poshtë.

Në mbështetje të pikës A të shtojcës së ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe /ose risigurimit”, grupet e sigurimit do të jenë si më poshtë:

1. Grupi nr 1 “Aksidente”
2. Grupi nr 2 “Sëmundjet”
3. Grupi nr 3 “Mjete tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)”
4. Grupi nr 6 “Anijet”
5. Grupi nr 7 “Mallrat në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve)”
6. Grupi nr 8 “Zjarri dhe forcat e natyrës”
7. Grupi nr 9 “Dëmtime të tjera të pasurisë”
8. Grupi nr 10 “Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve”
9. Grupi nr 13 “Përgjegjësitë civile të përgjithshme”
10. Grupi nr 15 “Garancitë”

Kjo leje për ushtrim aktiviteti është pjesë përbërëse dhe i bashkangjitet autorizimit zyrtar nr.5, datë 13.4.2001.

U lëshua sot në Tiranë, më datë 01.06.2001 nga KOMISIONI I MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE.

KRYETARI
Vangjel Birbo

